

**STUDIM BAZË:**

# **POLITIKAT DHE STRATEGJITË KOMBËTARE RRETH EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMACIONIN NË SHQIPËRI**



**Albanian Media Institute**  
Instituti Shqiptar i Medias

STUDIM BAZË:  
**POLITIKAT DHE STRATEGJITË KOMBËTARE  
RRETH EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE  
INFORMACIONIN NË SHQIPËRI**

Studim bazë: Politikat dhe Strategjitë Kombëtare rreth Edukimit për Median dhe Informacionin në Shqipëri

Copyright: © ISHM

Botues:



**Albanian Media Institute**  
**Instituti Shqiptar i Medias**

Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania  
Tel./fax: ++ 355 4 2229800  
E-mail: [info@institutemedia.org](mailto:info@institutemedia.org)  
[www.institutemedia.org](http://www.institutemedia.org)



Ky projekt financohet nga Bashkimi European



Organizata e Kombeve  
të Bashkuara për Arsim,  
Shkencë dhe Kulturë

Ky studim është realizuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Besimit në Media në Europën Juglindore dhe në Turqi, Faza e Dytë”, të financuar nga BE dhe UNESCO. Përbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Institutit Shqiptar të Medias dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit European dhe të UNESCO-s.

## Tabela e përmbajtjes

<b>Përmbledhje ekzekutive .....</b>	<b>5</b>
<b>I. Hyrje/Qëllimi i studimit bazë .....</b>	<b>8</b>
<b>II. Edukimi për Median dhe Informacionin si koncept i gjerë .....</b>	<b>14</b>
<b>III. Korniza e Zhvillimit për Politikrat dhe Strategjitë mbi EMI-n në Shqipëri .....</b>	<b>17</b>
<b>IV. Tablo e përgjithshme mbi EMI-n në Shqipëri .....</b>	<b>24</b>
<i>4.1 Politikrat EMI në edukimin formal .....</i>	<i>24</i>
<i>4.2 EMI në edukimin joformal .....</i>	<i>34</i>
<i>4.3 EMI në edukimin informal .....</i>	<i>44</i>
<b>V. Objektivat e Politikave për EMI-n .....</b>	<b>56</b>
<b>VI. Rekomandime Strategjike për Hartimin e Strategjisë Kombëtare për EMI-n .....</b>	<b>58</b>
<b>VII. Shtojca .....</b>	<b>62</b>
<b>Letër pozicionimi mbi politikrat dhe strategjitë kombëtare për edukimin për median dhe informacionin në Shqipëri .....</b>	<b>79</b>



## Përmbledhje ekzekutive

Ky studim bazë është realizuar në kuadër të projektit “*Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, faza e II-të*” mbështetur nga UNESCO dhe Bashkimi Evropian dhe të zbatuar në Shqipëri nga Instituti Shqiptar i Medias. Projekti, në këtë fazë të zbatimit të tij, ***synon që të rrisë aftësitë e të rinjve për edukimin mbi median dhe informimin (EMI) përmes integritit të kurrikulës së EMI-t të në sistemin edukativ formal në Shqipëri.*** Zbatimi i projektit filloi në Qershor 2020 dhe do të zgjasë deri në vitin 2022.

Një nga aktivitetet e projektit është ***përditësimi i situatës aktuale të EMI-në Shqipëri dhe identifikimi i aktorëve kyç, si edhe kontributeve që janë bërë për përmirësimin e nivelit të edukimit mbi median dhe informacionit në harkun kohor 2016-2020.*** Për ta bërë të mundur këtë proces Instituti Shqiptar i Medias ka mbledhur të dhëna parësore (nëpërmjet intervistave dhe konsultimeve kombëtare) dhe dytësore (*desk-research*, shqyrtimi i strategjive dhe dokumentave ekzistues). Të dhënat e mbledhura janë përpunuar dhe përfshirë në këtë studim të organizuara sipas fushave tematike në vijim: ***politikat dhe strategjitë ekzistuese për EMI-n, vështrim i përgjithshëm mbi EMI-n (politikat dhe nismat në arsimin formal, edukimin joformal dhe atë formal), si edhe objektivat politike dhe rekomandime strategjike për përmirësimin e nivelit të EMI-t.***

Në vendin tonë ***nuk ekziston ende një strategji që orienton politikat kombëtare për edukimin mediatik dhe informacionin, për t'iu përgjigjur nevojave në këtë fushë.*** Strategji të ndryshme kombëtare (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim; Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar; Agjenda Digjitale, Strategjia Kombëtare për Kulturën, etj.) cekin një apo disa elementë të EMI-t, sikurse është për shembull digjitalizimi i shërbimeve dhe rritja e aftësive kompjuterike, ***por mungon qasja e plotë e zhvillimit të kompetencave në EMI*** (të menduarit kritik, vlerësimi i informacioneve dhe burimeve të informacionit, aftësia për të aksesuar dhe lokalizuar burimet informative, krijimi i përmbajtjeve, nxitja e qytetarisë aktive, të kuptuarit e medias dhe sistemeve të informimit, etj).

***Kjo mungesë reflektohet gjithashtu edhe në të treja nivelet e edukimit, atij formal, joformal dhe informal.*** Ndonëse në sistemin parauniversitar i është dhënë përparësi përdorimit të TIK gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, ***kjo përparësi është e kufizuar vetëm në aspektin dhe edukimin teknologjik dhe përdorimit të paisjeve,*** duke mos u përqendruar në kompetencat e tjera të EMI-t. Integrimi i kurrikulës për EMI-n në kurrikulën e arsimit parauniversitar, do të shtonte njohuritë dhe aftësitë e nxnësve dhe mësuesve në fushën e edukimit për median dhe informimin.

***Në nivel universitar, koncepte të caktuara të EMI-t mësohen nga programe të ndryshme të formimit akademik të ciklit Bachelor dhe Master,*** në fakultete të universiteteve publike (Universiteti i Tiranës, Aleksandër Moisiu, Aleksandër Xhuvani, etj.) dhe private (Universiteti Beder, etj.). Këto koncepte në varësi të degëve përfshijnë njohjen me median, audiencën, kompetencën digjitale, prodhimin e përmbajtjeve multimediale, etj., por ajo që ***mbetet për t'u theksuar është***

***mungesa e formimit të përgjithshëm për EMI-n. Është e domosdoshme që ndërhyrjet për EMI-n të bëhen edhe në këtë nivel në tri dimensione: 1) operativ, 2) analitik, 3) krijues.***

Nisur nga nevojat e identifikuara dhe nga boshllëqet në nismat ekzistuese, ky dokument, i hartuar sipas një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe shumëpalëshe, ***sugjeron objektivat për politikat dhe strategjinë e EMI-t, të cilat duhet të shtrihen në arsimin formal (cikli universitar dhe para-universitar); në arsimin joformal dhe informal duke prekur kështu të gjitha shtresat e shoqërisë*** me synimin për të rritur nivelin e edukimit mbi median dhe informacionin në Shqipëri.





## HYRJE / QËLLIMI I STUDIMIT BAZË

Media dhe informacioni luajnë një rol vendimtar në një shoqëri demokratike pasi u japin mundësi qytetarëve që të marrin vendime të mirëinformuara, ndikojnë pozitivisht në fuqizimin e pozitës dhe nxisin dhënien e kontributit të tyre në shoqëri. Potenciali që sjellin teknologjitë e reja të informacionit është shumë i madh, kështu që qytetarët dhe media duhet të jenë në gjendje që t'i përdorin me zgjuarsi këto mjete të reja dhe të shmangin rreziqet që ato mbartin me vete. Në këtë drejtim, njohja dhe edukimi për median dhe informacionin(EMI) ka një rëndësi të dorës së parë në zhvillimin e mendimit kritik dhe përdorimit efikas të teknologjisë së medias dhe komunikacionit në një epokë kur përballemi me një mori informacionesh.

Tabloja mediatike shqiptare është dinamike përsa i përket numrit të organeve mediatike. Momentalisht ka 15 gazeta të përditshme, duke përfshirë këtu edhe gazeta sportive, ndonëse kemi më pak se tre milionë banorë dhe shtypi nuk shpërndahet nëpër të gjithë territorin e vendit. Edhe numri i mediave audiovizive është mjaft i lartë: janë lëshuar pesë licenca për platforma digjitale kombëtare, ka 45 stacione televizive lokale, si dhe radiotelevizioni publik RTSH që transmeton në 12 kanale, nëpërmjet platformës së tij digjitale, duke përfshirë edhe dy degë të televizionit në rrethe. Përsa

i përket transmetimeve radiofonike, ka dy radio kombëtare, 53 radio lokale dhe katër radio komunitetesh. Përveç tyre, funksionon edhe radio Tirana, që transmeton në gjashtë kanale radio dhe katër degë nëpër rrethe.

Nga ana tjetër, tabloja e mediave online është shumë më kaotike dhe në kushtet e mungesës së statistikave zyrtare apo mënyrave të tjera për të përlogaritur numrin e mediave online, vetëm mund të spekulohet në lidhje me përmasat e këtij sektori të medias. Sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, mendohet se në vend ka më shumë se 800 media online. Rritja dramatike e numrit të mediave online vjen si rrjedhojë e kostove relativisht të ulëta në krahasim me sektorët e tjerë të medias dhe përhapjes së gjerë të internetit nëpër të gjithë vendin. Sipas entit rregullator të komunikacioneve elektronike, niveli i përhapjes së internetit në fund të vitit 2019 ishte 75%. Po kështu, shqiptarët janë përdorues të rregullt të rrjeteve sociale, veçanërisht në Facebook, me rreth 1.4 milionë faqe, apo një nivel përhapje prej 49 për qind, deri në fund të muajit janar 2020.

Me zhvendosjen me shpejtesi të qendrës së gravitetit të medias shqiptare online, relievi mediatik duket se është përmbysur. Gazetaria shqiptare përjeton fenomenin e portalizimit dhe facebook-izimit dhe ashtu si në vende të tjera prodhon vetë dhe përballet me lajmë të rreme të përditshme. Teoritë e konspiracionit, që më parë gjendeshin vetëm në mediat ekstremiste, tani po dominojnë gjerësisht median tradicionale. Disinformimi paraqitet si një problem serioz që duhet përballuar. Kjo u vu re qartë gjatë pandemisë së COVID-19, kur teoritë e konspiracionit dhe dezinformacionet u përhapën me shpejtësi.

*Përvoja ka treguar se publiku shqiptar nuk ka imunitetin e nevojshëm dhe aftësitë e duhura për t'u përballur me lajmet e rreme (fake news) dhe dezinformacionet, nuk ka qasjen*

*kritike të domosdoshme për të dalluar të vërtetën, për të dalluar çfarë është fake news dhe çfarë është real news* etj. Indexi i Media Literacy i 2018 e vendos Shqipërinë gati në fund të listës së vendeve europiane, duke lënë pas vetëm Turqinë dhe Maqedoninë e Veriut.<sup>1</sup> Renditje kjo që sinjalizon domosdoshmërinë e ndërhyrjeve të menjëhershme dhe planifikimin e ndërhyrjeve strategjike për të përmirësuar nivelin e edukimit për median dhe informimin në Shqipëri.

Studimi Bazë synon të paraqesë situatën reale në lidhje me EMI-n në Shqipëri, duke u bazuar në Udhëzimet e Politikave të UNESCO-s mbi Edukimin për Median dhe Informacionin<sup>2</sup>. Studimi Bazë aktual është një përditësim i punës së filluar në vitin 2017, ku u realizua edhe studimi bazë fillestar, që ishte pikënisja për çeljen e diskutimeve dhe debateve gjatë takimeve konsultative mbi EMI-n që u zhvilluan në Tiranë. Asokohe, pjesëmarrës në këto takime ishin përfaqësues të institucioneve si Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, universitete dhe institucione të ndryshme arsimore, përfaqësues nga Biblioteka Kombëtare, autoriteti rregullues i mediave audiovizive- AMA, organizatat e gazetarëve, ekspertë të medias, organizata që merren me median dhe rininë, gazetarë dhe organizata të shoqërisë civile. Konsultimet nxorrën në pah tendencat kryesore dhe identifikuan aktorët kryesorë që janë të përfshirë, apo që mund të angazhohen, në kuadër të EMI-t, dhe rolet e veçanta që gjithsecili duhet të luajë për

---

<sup>1</sup> Lessenski, M. (2018). *Common sense wanted. Resilience to post-truth and its predictors in the new media literacy index 2018\**. Open Society Institute, Bulgaria.

<sup>2</sup> Mund të lexohet tek: <http://www.unesco.org/new/en/communication-and-information/resources/publications-and-communication-materials/publications/full-list/media-and-information-literacy-policy-and-strategy-guidelines/>

të hartuar një strategji holistike dhe komplekse në edukimin formal, joformal dhe informal.

Në të njëjtën linjë është organizuar edhe mbledhja e informacionit në këtë fazë të dytë, ku me palët e interesuara dhe aktorët kryesorë që luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me EMI-n janë zhvilluar intervista për të marrë informacion të detajuar lidhur me rolin dhe kontributin e tyre në këtë fushë. Kështu, gjatë muajit Tetor dhe Nëntor janë zhvilluar 27 intervista me përfaqësues nga insitucionet publike, insitucionet arsimore, mediat/institucionet mediatike dhe organizatat e shoqërisë civile. Më specifikisht janë intervistuar përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, ASCAP, Ministria e Kulturës, Kryeministria, Muzeu Historik Kombëtar, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Bibiloteka Kombëtare, Qendra TUMO, Radio Televizioni Publik Shqiptar, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Këshilli Shqiptar i Medias, Universiteti i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Universiteti Bedër, UNICEF, Qendra për Gazetari Cilësore, Faktoje.al, Qendra për të Drejtat e Fëmijëve, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën, etj. *(Një listë e plotë e aktorëve të intervistuar mund të gjendet tek shtojcat në fund të këtij dokumenti).*

Të dhënat e përfshira në këtë studim janë parësore (të mbledhura nga intervistat) dhe dytësore (desk-research). *Studimi, fill pas konsultimit të draft-dokumentit, do të vihet në dispozicion të qeverisë dhe palëve të tjera të përfshira në këtë proces për të rekomanduar hapa specifikë që duhen marrë për të integruar edukimin për median dhe informacionin në edukimin formal, joformal dhe informal në Shqipëri. Kjo punë zhvillohet në kuadër të projektit “Krijimi i besimit në media në Evropën Juglindore dhe Turqi, Faza e II-të”, mbështetur nga UNESCO dhe BE, që përtej ndërhyrjes së planifikuar synon të krijojë qëndrueshmëri sa i përket edukimit për median*

dhe informacionin, si edhe të nxisë hartimin e Strategjisë Kombëtare për Edukimin për Media dhe Informacionin, që aktualisht nuk ekziston.

## **NJË PËRQASJE SHUMËPALËSHE: PËRSE ËSHTË THELBËSORE?**

Një ndërhyrje komplekse dhe gjithpërfshirëse si EMI kërkon një angazhim shumëpalësh, ndërdisiplinor dhe ndër-institucional. Kështu edhe politikat dhe strategjitë për EMI-n është e nevojshme të krijohen mbi konceptin e edukimit për median dhe informimin që harmonizon dhe përmbledh një shumëllojshmëri aftësish të tjera themelore në epokën digjitale, siç janë aftësimi për lajmet, televizionin, filmat, kompjuterat, internetin, median sociale, arkivat, bibliotekat, muzetë, qendrat burimore etj. Përpjekjet për të identifikuar nevojat dhe për të hartuar politika dhe strategji për të zgjidhur problemin e EMI-t nuk do të jenë të plota pa përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara që mund të kontribuojnë në të ardhmen në zhvillimin e EMI-t në Shqipëri, si aktorët qeveritarë, të shoqërisë civile, të insitucioneve arsimore, të medias dhe të biznesit.

Këta aktorë mund të jenë nga fusha të ndryshme të edukimit formal, joformal dhe informal dhe mund të ndihmojnë në procesin e edukimit për median dhe informacionin nëpërmjet mjeteve dhe teknikave të ndryshme. Aktualisht institucionet zyrtare që merren me çështje të arsimit janë të përfshira, sikurse është Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP). Po ashtu, shkollat e ciklit të ulët dhe të mesëm do të jenë pjesë e pilotimit të këtij projekti. Universitetet do të jenë një nivel tjetër ndërhyrjeje së bashku me organizata apo insitucione të edukimit të vazhduar në mënyrë që edukimi

për median dhe informacionin të shndërrohet në kulturë në çdo nivel dhe strukturë edukimi.

Aktorë të tjerë të rëndësishëm që duhen përfshirë janë mediat, institucionet rregullatore dhe vetë-rregulluese, bibliotekat shtetërore dhe ato të shkollave, shoqatat e mësuesve dhe prindërve, shoqatat e bibliotekave, përçuesit e ndryshëm të informacioneve, përdorues të mediave sociale, institute trajnimi, institucione të ndryshme të ruajtjes së dijes dhe kujtesës, ndërmjetës në procesin e informimit, etj.

Ndryshimet thelbësore në panoramën mediatike dhe informative tregojnë se shkollat nuk janë më të vetmet burime të njohurive dhe nxënies. Kjo nënkupton edhe rolin që duhet të luajnë institucionet mësimdhënëse informale dhe të ndërmjetme, si bibliotekat, arkivat, muzetë dhe institucione të tjera kulturore.

Në Shqipëri përgatitjet dhe përpjekjet për edukimin për median dhe informacionin janë ende në hapat e para dhe projekti në fjalë është një ndër ndërhyrjet më të konsoliduara pasi synon ta bëjë EMI-n pjesë të kurrikulës zyrtare në arsimin parauniversitar. Megjithatë, është e rëndësishme që të përfshihen sa më shumë aktorë nga palët e interesuara që të jetë e mundur, me qëllim që të sigurohet arritja e rezultateve pozitive në këtë fushë, si edhe të krijohet një sinergji mes gjithë kontributeve që po jepen në këtë drejtim, qofshin ato sporadike dhe aftashkurtra, apo afatgjata dhe të qëndrueshme.



## EDUKIMI PËR MEDIAN DHE INFORMACIONIN SI KONCEPT I GJERË

“Edukimi për median” dhe “edukimi për informacionin” tradicionalisht janë konsideruar dhe trajtuar si dy fusha më vehte, mirëpo kalimi në epokën digjitale dhe përparimet në teknologji kanë sjellë transformimin dhe shkrirjen e të dy termave duke krijuar kështu një koncept më gjithëpërfshirës që i ngërthen të dyja: “edukimin për median dhe informacionin”. Në këtë kontekst, ky Studim Bazë përdor përkufizimin e UNESCO-s mbi Edukimin për Median dhe Informacionin si pikënisje për të paraqitur një koncept më të gjerë që përfshin edhe EMI-n si një tërësi kompetencash (njohuri, aftësi dhe qëndrime) të domosdoshme për jetën dhe punën. Edukimi për Median dhe Informacionin përfshin të gjitha llojet e mediave dhe ofruesve të informacionit, sikurse janë libraritë, bibliotekat, arkivat, muzetë, por edhe informacionin e marrë nëpërmjet internetit pavarësisht paisjes ku aksesohet, apo platformës ku merret informacioni. EMI i pajis qytetarët me aftësitë dhe kompetencat për të qenë qytetarë aktive dhe kritikë, që mund të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe të formëzojnë demokracinë. *Kompetencat që EMI synon të zhvillojë janë aftësia për të aksesuar dhe lokalizuar burimet e informacionit; aftësia për të përdorur dhe kuptuar median dhe informacionin për ta aplikuar atë në jetën e përditshme; aftësia për të vlerësuar besueshmërinë,*

*saktësinë dhe objektivitetin e burimeve; aftësia për të krijuar dhe prodhuar media dhe informacion; aftësia për të marrë pjesë duke ditur si dhe kur të ndërveprojë me krijuesit dhe edituesit e medias dhe informacionit; aftësia për të kuptuar mënyrën e funksionimit të medias dhe sistemeve të informimit, organizimin e tyre dhe mënyrën e prodhimit të informacionit; aftësia për të njohur, kërkuar dhe mbrojtur median cilësore dhe burimet e informimit.*

Në thelb, një kuptim më i gjerë i konceptit EMI ka për qëllim të harmonizojë përjasjen ndaj edukimit për median dhe informacionin dhe ta aplikojë këtë koncept në kontekstin arsimor në Shqipëri. Për këtë qëllim ky studim do të marrë në shqyrtim edukimin për median, edukimin kompjuterik, edukimin për internetin dhe edukimin digjital<sup>3</sup>. Kjo arrihet duke marrë në konsideratë legjislacionin, rregulloret, dokumenta dhe strategji që merren me këto çështje, si dhe iniciativa të marra nga shoqëria civile dhe publiku i gjerë. Kjo gjithashtu merr në konsideratë situatën dhe nevojat në terren, si edhe faktin që në Shqipëri ende nuk ekziston një strategji kombëtare për EMI-n dhe që njohuritë bazë për të nuk jepen as në arsimin e mesëm e as atë të lartë. Në shkolla i kushtohet vëmendje kryesisht aftësimit të nxënësve në përdorimin e kompjuterave; në programe përfshihen: dhënia e njohurive të përgjithshme për kompjuterat, për programet kryesore, për internetin, postën elektronike. Ndërsa në universitete organizohen kurse vetëm për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, ose të medias, pra nuk ka një orientim të

---

<sup>3</sup> EMI si koncept më i gjerë përfshin: edukimin për bibliotekat, edukimin për lajmet, edukimin digjital, edukimin kompjuterik, edukimin për internetin, edukimin për lirinë e shprehjes dhe të drejtës së informimit, edukimin për televizionin, edukimin për reklamën, edukimin mbi kinemanë, dhe edukimin për lojra (UNESCO, MIL Policy and Strategy Guidelines – UNESCO, Politikat dhe Udhëzime Strategjie mbi EMI-n)



mirëfilltë mbi EMI-n sikurse konceptohet nga UNESCO dhe në këtë dokument. Aktualisht edukimi për informacionin është i përfshirë vetëm në arsimimin bibliotekar kombëtar, ku është edhe ndër më parësorët, por megjithatë ky edukim nuk përfshin pjesën e medias dhe sërish mbetet i pjesshëm. *Në këtë drejtim, ky studim do të ofrojë rekomandime për hartimin e politikave dhe strategjive në fushën e edukimit për median dhe informacionin në Shqipëri.*



## **KORNIZA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE EMI NË SHQIPËRI**

Politikat dhe strategjitë mbi edukimin për median dhe informacionin (EMI) në Shqipëri duhet të shihen dhe të gjykohen në kontekstin social, politik dhe kulturor të vendit tonë. Një nga forcat shtytëse për reformë dhe nxitje drejt politikave dhe rregullave të reja në vend ka qenë procesi i integritimit në Bashkimin Evropian, ku Shqipëria është vend kandidat. Ndonëse progresi në këtë proces është i ngadaltë, ka patur një ndikim të rëndësishëm në fushën e legjislacionit, duke i kushtuar rëndësi faktit që politikat e reja dhe legjislacioni i miratuar të jetë në linjë me standardet dhe legjislacionin e BE-së dhe disa herë është kërkuar edhe asistenca e BE-së në hartimin e legjislacionit. Përrjashtim nuk bën as pjesa e legjislacionit që prek fushën e EMI-t, mbështetur kjo në rastin e hartimit të legjislacionit mbi mediat audiovizive, legjislacionit mbi tregtinë elektronike (e-commerce), kalimit në transmetimet televizive digjitale, komunikimet elektronike, etj.

Një parakusht thelbësor për përmirësimin e aksesit të publikut në media dhe informacionin është përmirësimi i infrastrukturës së informacionit dhe teknologjisë, si dhe përmirësimi i ndjeshëm në nivelin e përdorimit të internetit gjatë këtyre viteve të fundit. *Qeveria shqiptare ka deklaruar*

*si prioritet për vite me radhë digjitalizimin dhe krijimin e një shoqërie të orientuar drejt njohurive dhe informacionit, si në konsolidimin e një shoqërie më të hapur dhe të zhvilluar, ashtu edhe në përmirësimin e nivelit ekonomik.* Përprojektet kanë qenë konsistente në adoptimin e politikave për krijimin dhe nxitjen e shërbimeve qeveritare në mënyrë elektronike, duke tentuar që të lehtësojnë dhënien e informacionit dhe shërbimeve të ofruara ndaj qytetarëve të tyre. Portali qeveritar e-albania është një produkt i këtyre përpjekjeve. Duke qenë portal shumëfunktional e-albania.al administrohet dhe zhvillohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe shërben si një portë nëpërmjet së cilës çdo person i interesuar mund të marrë nëpërmjet internetit, shërbime elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri. Portali qeveritar e-Albania është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë mbi të cilën mundësohet ndërveprimi me sistemet elektronike të institucioneve publike. Vetëm në muajin Tetor 2020, numri total i përdorimeve të shërbimeve elektronike ka qenë 1,341,627<sup>4</sup> dhe numri i regjistruarëve të rinj për këtë muaj ka qenë 37,330 persona, shifra këto që tregojnë për numrin në rritje të përdorimit të shërbimeve qeveritare online.

*Një politikë tjetër qeveritare ka qenë përmirësimi dhe përforcimi i bazës teknologjike në shkollë, me qëllim që të angazhohen gjerësisht nxënësit në mësimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).* Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit është treguar e gatshme për të mbështetur përpjekjet për të reformuar kurrikulën dhe krijimin e mundësive të mjaftueshme për mësuesit që të edukojnë brezat e rinj për median dhe informacionin. Megjithatë digjitalizimi i plotë i

---

<sup>4</sup> Marrë nga e-albania, statistikat për muajin Tetor 2020.  
<https://e-albania.al/Pages/Statistics/statistika.pdf>

arkivave dhe informacionit nëpër institucione të ndryshme nuk ka ecur me ritme të shpejta, ka patur arritje në disa fusha të tjera si bibliotekat, muzetë, arkivin qendror dhe disa baza të dhënash.

## **EMI në qendër të strategjive dhe politikave të qeverisë qendrore dhe institucioneve publike**

*Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve* - është duke punuar me përditësimin e Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar (SZHAPU). Deri më tani prioritet ka pasur dhe do të ketë përdorimi i TIK në shkollë nga mësuesit dhe nxënësit për të pasur një përvojë sa më efektive në mësimdhënie-mësimnxënie. Përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor kontribuon në zhvillimin e kompetencës digjitale tek nxënësit, që është një nga aspektet e EMI-t. Përkushtimi për digjitalizimin e arsimit është shprehur në SZHAPU ku promovimi i aftësive digjitale te nxënësit, si dhe integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe në të nxënë është një prioritet dhe është ripohuar në Programin e Qeverisë për periudhën 2017-2021. Në periudhën mars-qershor 2020 kur, për shkak të pandemisë COVID-19, mësimi u zhvillua nga distanca, MASR mori mbi vete obligimin për krijimin e burimeve online në formë të video-regjistrimeve, ndërsa ASCAP nxori udhëzues për organizimin e mësimit nga distanca në kushte të emergjencës globale. Gjatë mësimit në distancë që u organizua në periudhën mars-qershor 2020 mësuesit dëshmuar se mund t'i përshtaten shpejtë rrethanave, duke shfrytëzuar platforma komunikimi dhe softuerë që i shërbejnë integritit më të mirë të TIK në procesin mësimor, prandaj është e domosdoshme të bëhet një hap përpara duke ofruar trajnime, këshillim dhe udhëzime të qarta për punën në këtë drejtim.

***Njësia e Programeve të Zhvillimit dhe Bashkëpunimit në Kryeministri*** ka në zhvillim e sipër programin për “Start up-et dhe inovacionin”, si edhe “Smart Cities”, që të dyja synojnë të rrisin nivelin e digjitalizmit në nivel kombëtar dhe angazhimin e të rinjve në themelimin e start-up-eve në fushën e teknologjisë dhe industrive kreative. Në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes kjo njësi ka draftuar dhe është në proces të miratimit të ligjit për start-upet dhe inovacionin.

***Ministria e Kulturës***, në Strategjinë Kulturore Kombëtare 2019-2025<sup>5</sup> ka theksuar vëmendjen e veçantë për edukimin përmes kulturës, si edhe ka bërë përpjekje për krijimin e audio-guidave, përdorimin e biletave elektronike<sup>6</sup>, uljen e çmimeve për studentët dhe kategoritë vulnerable për të rritur aksesin e tyre në sitet kulturore dhe çeljen e tureve virtuale, si edhe akordimin e fondit për digjitalizimin. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me AADF-në është në proces krijimi i qendrave digjitale për trashëgiminë kulturore jo-materiale. Po ashtu, Ministria e Kulturës për të nxitur edukimin përmes kulturës ka lançuar edhe thirrjet për projekt-propozime kulturore, që në mënyrë të veçantë kanë në fokus krijimin dhe përdorimin e shërbimeve kulturore digjitale.

***Muzeu Historik Kombëtar***, në programin e tij ka komponentë të edukimit për informacion dhe po ashtu në kuadër të programit të edukimit përmes kulturës ka nisma si “Arkeologu i Vogël”<sup>7</sup>, “Muzeu im”, “Një ditë me kuratorin”, si edhe “Një pasditë në muze”. Përpos këtyre nismave për nxitjen e edukimit përmes kulturës MHK-ja përgatit almanakun

---

<sup>5</sup> <https://kultura.gov.al/programi-i-kultures-2019-2025/>

<sup>6</sup> <http://cultureticketsalbania.al/>

<sup>7</sup> <http://www.mhk.gov.al/>

kulturor, organizon kronika informuese në televizion, kryen prezantime si edhe botime manualesh dhe librash. Në nivel universitar organizohen leksione të hapura. Në përpjekje për digjitalizimin e shërbimeve MHK është duke punuar për krijimin e guidave audio-vizuale, si edhe organizmin e quizeve dhe konkurseve të ndryshme.

***Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë*** - ka funksione dhe sektorë të shumëllojshëm, por roli i Sektorit të Informatikës dhe Teknologjive të Reja është veçanërisht i rëndësishëm përse i përket informimit dhe afrimit të publikut me median dhe informacionin, pasi mundëson, orienton dhe organizon integrimin e teknologjisë së informacionit në punën e përditshme të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Aktualisht, baza e të dhënave të BKSH-së përmban 447.336 materiale bibliotekare (libra, artikuj, harta, dorëshkrimeve etj.), që mund të kërkohen online dhe mbi 265.000 faqe librash, revistash, dorëshkrimesh, antikuarësh, hartash, që janë tashmë të digjituara dhe të aksesueshme online. Gjithashtu, BKSH-ja është një nga insitucionet që aktualisht ka një strategji vjetore të konsoliduar sa i përket arsimimit dhe trajnimit të stafit të saj, si dhe punonjësve të bibliotekave të sistemit kombëtar në *Aftësim për Informacion*. Më tej akoma, ky institucion ofron mundësi edhe për *Aftësimin në Informacion* dhe teknologji të fëmijëve dhe të të rinjve, nëpërmjet një sërë programesh që zbaton, të cilat do të sqarohen më në detaje në vijim. Në vitin 2014 BKSh-ja u përfshi në nismën europiane të festimit të 40-vjetorit të përdorimit të termit “Aftësim në Informacion” duke organizuar në vend konferencën e parë shkencore “Aftësimi në Informacion përmes Teknologjive të Reja të Komunikimit”, si dhe duke i kushtuar më pas vëmendje, jo vetëm botimit të akteve të konferencës, por edhe përkthimit në shqip të

dokumentave ndërkombëtare bazë (manifeste/deklarata) për *Aftësimin në Informacion*.

***Komisioni Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*** që ka përgjegjësi mes të tjerave edhe çështjet e arsimit, kulturës, medias së shkruar dhe asaj vizive ka njohur prej vitesh nevojën për edukim për media dhe informacion. Situata aktuale e medias në Shqipëri, përhapja e lajmeve të rreme dhe konspiraconeve kërkon ndërhyrje dhe adresim. Në këto rrethana KEMIP është i interesuar për nisma që synojnë të përmirësojnë nivelin e edukimit mediatik dhe atij informativ.

***Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)*** në cilësinë e autoritetit rregullator për median audiovizive dhe shërbimet mbështetëse në Planin Strategjik të Veprimit 2021-2023 ka bërë pjesë të Objektivit 3-për një qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme edhe hartimin dhe realizimin e një sërë veprimtarish që promovojnë edukimin mediatik. Kjo me qëllim për të nxitur aftësinë e audiencave për të vlerësuar dhe kuptuar përmbajtjet audiovizive, në një mjedis mediatik në zhvillim.

Ndonëse qeveria dhe ministritë e linjës, institucione të tjera kërkimore dhe trajnimi, si edhe ato vendore kanë rol parësor në hartimin e politikave dhe legjislacionit mbi EMI-n, sektori i shoqërisë civile është munduar të ndikojë dhe të ndihmojë në disa aspekte të edukimit për median dhe informacionin, si trajnimi i të rinjve dhe qytetarëve në prodhimin e materialeve mediatike, përpjekjet për të futur edukimin për median dhe informacionin si lëndë të veçantë në shkolla dhe përpjekje të tjera për të zhvilluar aftësi të mendimit kritik, veçanërisht tek të rinjtë. Gjithashtu, shoqëria civile është angazhuar në projekte që synojnë t'u

krijojnë mundësi shtresave dhe komuniteteve në nevojë që të përvetësojnë aftësi të prodhimit të materialeve mediatike si dhe t'u mundësojnë akses në kanalet e komunikimit, si në rastet e minoriteteve etnike dhe gjuhësore, komunitetit LGBT, komunitetit rom dhe egjiptian, të rinjve me më pak mundësi, etj.

Sidoqoftë, ende nuk ka një strategji zyrtare, formale dhe politika që e trajtojnë EMI-n si koncept kompleks. Qeveria dhe shoqëria civile po merren më çështje dhe aspekte të ndryshme, ndonjëherë edhe në bashkëpunim me njëra-tjetrën, por komponentët e ndryshëm dhe përqsjet e ndryshme në kuadër të EMI-t janë akoma të pazhvilluara sa duhet në aspektin e politikave, strategjive dhe zbatimit.



# IV

## TABLO E PËRGJITHSHME E EMI-T NË SHQIPËRI

Ky studim përqendrohet mbi politikat aktuale mbi EMI-n në Shqipëri, në tri aspekte: në arsimin formal, edukimi joformal dhe informal.

### 4.1 POLITIKAT EMI NË EDUKIMIN FORMAL

Kuadri ligjor mbi arsimin para-universitar në Shqipëri përmbledhet kryesisht tek ligji 69, i miratuar në vitin 2012 “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë.” Objektivi kryesor i këtij ligji është përcaktimi i parimeve bazë mbi strukturën, aktivitetet, dhe administrimin e sistemit shkollor para-universitar në Shqipëri, duke u munduar që të garantojë të drejtën kushtetuese të të gjithë qytetarëve për arsim<sup>8</sup>. Ky ligj ka të bëjë kryesisht me arsimin e përgjithshëm, ndërsa arsimi profesional mbulohet nga një tjetër ligj i posaçëm.

Ligji mbi arsimin para-universitar i jep të drejtë dhe kompetenca organeve respektive që të hartojnë kurrikulat, por nga ana tjetër nënvizon faktin se i gjithë sistemi

---

<sup>8</sup> Ligji nr. 69/2012, “Për arsimin para-universitar,” Neni 1

arsimor para-universitar duhet të bazohet mbi mësimin dhe zhvillimin e njohurive (kompetencave), duke identifikuar dhe përcaktuar njohuritë që çdo nxënës duhet të fitojë nga shkollimi para-universitar. Disa kompetenca kanë të bëjnë me EMI-n, dhe për pasojë mendohet se disa njohuri apo aftësi të edukimit për median dhe informacionin përfitohen në këtë proces<sup>9</sup>.

Kompetencat që përmenden në ligj janë në terma të gjera dhe nuk jepen detaje apo saktësime mbi ndonjë element të veçantë, por paraqiten si një listë e njohurive dhe aftësive themelore që çdo nxënës duhet të përvetësojë nga shkollimi para se të hyjë në arsimin universitar. E vetmja njohuri, apo aftësi që përmendet në mënyrë specifike është kompetenca digjitale, që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me edukimin për median dhe informacionin. Përdorimi i teknologjive të reja dhe përvetësimi i kompetencave digjitale nga ana e nxënësve theksohet edhe në Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Arsimor Para-Universitar 2014-2020.

Në kapitullin ku shpalosen vizionet, parimet dhe prioritetet e politikave qeveritare mbi arsimin para-universitar thuhet se “jetësimi progresiv i këtij vizioni do të krijojë kushte dhe mundësi që nxënësit... të përdorin teknologjitë e reja,”<sup>10</sup> ndër të tjera<sup>11</sup>. Disa nga elementet dhe metodat e nevojshme

---

<sup>9</sup> Në mënyrë më specifike kompetencat bazë që përmenden në legjislacion përfshijnë: komunikimin dhe shprehjen; mendimin; aftësimin për të kuptuar; kompetencat për jetën, ndërmarrjen private dhe ambientin; aftësi personale; aftësi qytetare; dhe kompetenca digjitale. Gjithashtu, shtesa në ligj në vitin 2015 përfshijnë midis qëllimeve të sistemit arsimor para-universitar edhe mësimin e nxënësve me përdorimin e teknologjive të reja.

<sup>10</sup> Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Para-Universitar 2014-2020

<sup>11</sup> Kjo është një pikë ku është vënë theksi edhe në strategjinë e mëparshme mbi arsimin, për vitet 2009-2013. Një nga prioritetet e strategjisë së mëparshme ka të bëjë me përfshirjen e gjerë të TIK në kurrikula, në përdorimin e TIK nga nxënësit dhe përmirësimin e shanseve të tyre në tregun e punës.

për të arritur këtë qëllim kanë të bëjnë me përmirësimin e infrastrukturës teknologjike në shkolla, në përdorimin e materialeve multimediale për kurrikulat mësimore, krijimin e laboratorëve të lëvizshëm për shkolla, si dhe përfshirjen e TIK-ut në lëndë të ndryshme të programeve arsimore<sup>12</sup>.

Përveç ligjit dhe strategjisë mbi arsimin para-universitar, udhëzime dhe orientime më specifike jepen edhe nga kurrikula bërthamë, që është dokumenti kryesor për orientimin dhe hartimin e planeve mësimore dhe lëndëve. Vetë kurrikula bërthamë bazohet mbi Kornizën Kurrikulare (Shiko Shtojcën 3). Korniza Kurrikulare e përcakton kompetencën digjitale si “përdorimin kritik dhe efektiv të TIK-ut në punë, gjatë kohës së lirë dhe gjatë komunikimit. Ajo mbështetet në shkathtësitë themelore të përdorimit të kompjuterit për të gjetur, prodhuar, krijuar, prezantuar dhe shkëmbyer informacion, si dhe për të bashkëpunuar në rrjetet informuese në internet.”<sup>13</sup>

Korniza Kurrikulare e konsideron teknologjinë dhe TIK si një nga fushat kryesore të mësimin dhe në mënyrë që të avancohet me shpejtësi në këtë fushë rekomandon integrimin e saj dhe shtrirjen në të gjitha fushat e të nxënës në disa shkallë, në mënyrë graduale, nëpër të gjitha ciklet e sistemit shkollor para-universitar<sup>14</sup>. Meqë bazohet mbi kornizën kurrikulare, edhe kurrikula bërthamë është hartuar duke përfshirë njohuritë apo kompetencën digjitale në listën e aftësive kryesore që duhen përvetësuar nga nxënësit, ashtu si TIK dhe teknologjitë e reja, si një nga shtatë fushat kryesore të të nxënës.

---

<sup>12</sup> Po aty

<sup>13</sup> Po aty

<sup>14</sup> Në fazën fillestare, lënda TIK shpërndahet në disa lëndë të ndryshme ; në fazën e dytë TIK dhe teknologjia futet si lëndë më vete, ndërsa në fazën e tretë dhe fazën e katërt, do të ketë njohuri më të avancuara për të prezantuar nxënësit me njohuri më të thelluara

Përveç TIK, që është një lëndë më vete, ka edhe elemente të orëve të tjera të mësimi që lidhen me gjetjen, vlerësimin dhe interpretimin e tekstit në media, e kombinuar me zhvillimin e aftësisë për të menduar në mënyrë kritike. Në veçanti kjo ka të bëjë me lëndën e gjuhës shqipe dhe komunikimin, si edhe lëndët e edukatës qytetare, që janë pjesë e kurrikulës bërthamë, që e bëjnë atë një lëndë të detyrueshme. Kështu, programi mësimor për lëndën e gjuhës shqipe dhe komunikimin për klasat 1-6, përmend si një nga objektivat kryesore “kërkimin, gjetjen, vlerësimin dhe përdorimin kritik të informacionit nga media dhe interneti.”<sup>15</sup> Po kështu, kurrikula e lëndës së edukatës qytetare rendit midis njohurive dhe aftësive që duhen përvetësuar nga nxënësit elementë që lidhen me EMI-n<sup>16</sup>.

Megjithëse edukimi për median dhe informacionin nuk përmendet si kompetencë dhe nuk renditet midis njohurive dhe aftësive kryesore që duhet të përvetësohen nga nxënësit e sistemit shkollor para-universitar, elemente të veçanta të disa lëndëve lidhen me disa komponentë të edukimit dhe njohjes së mirë me median, si vlerësimi i informacionit, aksesit në informacion, si dhe krijimi i përmbajtjes mediatike

---

<sup>15</sup> Disa nga aftësitë përfshijnë : nxjerrjen e informacionit kryesor nga një libër, gazetë, revistë, radio, TV, etj, dhe komentimi, si dhe përdorimi i tyre si referencë në detyrat e shtëpisë ; përdorimi i mediave digjitale dhe mjeteve të informimit për komunikim dhe bashkëpunim, duke përfshirë edhe komunikimin online; analizimin, vlerësimin, dhe administrimin e informacionit të marrë në mënyrë elektronike (p.sh., krijimi i një tablele apo grafiku nga informacioni i marrë nga interneti.)

<sup>16</sup> Strategjia aktuale e sistemit shkollor para-universitar pranon se “me gjithë investimet e bëra, përdorimi i TIK-ut në institucionet arsimore është i kufizuar. Pajisjet e ofruara me financime publike, në pjesën më të madhe, nuk shfrytëzohen si duhet ose kanë dalë jashtë përdorimit. Nga shkollat e arsimit bazë publik, raportohen 15,731 kompjutera personale, nga të cilët vetëm 11,331 janë funksionale. Shkollat raportojnë 1,631 laptopë, nga të cilët 432 janë jashtë funksionit.

dhe shpërndarja e materialeve nëpërmjet kanaleve të komunikimit.

Në kuadër të këtij projekti është hartuar draft-kurrikula e EMI-t për mësuesit e ciklit parauniversitar në bashkëpunim me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP). Kurrikula është mbështetur në kuadrin e kompetencave të UNESCO-s dhe do të bëhet pjesë e kurrikulës zyrtare në ciklin e arsimit parauniversitar, që do të pilotohet fillimisht në 20 shkolla, fillore dhe të mesme, në Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Elbasan, si në zonat rurale dhe ato urbane. Kjo do të jetë kurrikula e parë e integruar për EMI-n në arsimin formal në Shqipëri.

Kuadri kurrikular shpjegon një strukturë për zhvillimin e një programi studimi rreth edukimit për median dhe informacionin dhe përmes niveleve të ndryshme të përfshirjes në fushën e medias dhe të kanaleve të informimit. Kompetencat përcaktojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që pritet të zhvillojë kjo kurrikul. Duke u bazuar në rekomandimet e grupit të ekspertëve të UNESCO-s për edukimin për median dhe informacionin dhe në modulet e zhvilluara për të shoqëruar kornizën kurrikulare, u skicuan edhe tri fusha kryesore tematikash të ndërlidhura me njëra-tjetrën, si fusha të gjera kurrikulare në të cilat përfshihet edhe kurrikula e edukimit për median dhe informacionin për mësuesit. Ato janë: 1) Njohja dhe të kuptuarit e medias dhe informimit për dialogun demokratik dhe pjesëmarrjen shoqërore; 2) Vlerësimi i teksteve të medias dhe të burimeve të informacionit; 3) Prodhimi dhe përdorimi i medias dhe informacionit.

Draft-kurrikula iu është paraqitur mësuesve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, të cilat janë përzgjedhur për të qenë pjesë e pilotimit, për ta shqyrtuar dhe për të dhënë sugjerime lidhur me të. Gjatë muajit Dhjetor 2020 u zhvilluan edhe takimet e dyta me të njëjtët mësues për të mbledhur komentet

dhe sugjerimet e tyre konkrete lidhur me draft-kurrikulën, të cilat do të integrohen sipas relevancës që do të kenë.

## ZHVILLIMI I LËNDËS SË TIK NË SHKOLLA

Futja e lëndës së TIK në shkolla dhe përmirësimi i infrastrukturës për këtë subjekt ka qenë një prioritet i qeverive gjatë këtyre viteve të fundit. Sidoqoftë, zhvillimi i lëndës TIK në shkolla ka hasur në disa probleme, për arsye dhe faktorë të ndryshëm. Para të gjithash, hendeku i moshës midis mësuesve dhe nxënësve bën që këta të fundit janë më të favorizuar përsa i përket njohurive dhe aftësive teknologjike. Së dyti, infrastruktura teknike e nevojshme për të zhvilluar lëndën TIK është përmirësuar disi, por mbetet akoma shumë për të bërë në këtë drejtim<sup>17</sup>. Së treti, lënda TIK është relativisht e re për mësuesit dhe për pasojë ata përballesh me sfidat e mësimit të një lënde të re për nxënësit e tyre, që shpesh kanë njohuri dhe aftësi më të përparuara se vetë mësuesit në këtë fushë.

Sipas strategjisë së arsimit para-universitar, aktualisht mësuesit duhet të trajnohen për 18 orë çdo vit<sup>18</sup>. Sidoqoftë, përvoja ka treguar se deri tani trajnimi mbi TIK-un ka qenë i pamjaftueshëm. Shpesh kjo lëndë jepet nga mësues që kanë marrë vetëm një trajnim të shkurtër në këtë fushë dhe janë diplomuar në degë të tjera, si fizikë, apo matematikë dhe marrin këtë lëndë më shumë si një mënyrë për të plotësuar orët e mësimit që duhet të kryejë një mësues gjatë javës. Mangësitë në trajnimin zyrtar të mësuesve nuk janë kompensuar nga ndonjë iniciativë e sektorit të organizatave jo-qeveritare, si në fushën e TIK-ut, ashtu edhe në edukimin për median dhe informacionin.

---

<sup>17</sup> ibid

<sup>18</sup> Po aty

Në këtë drejtim, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar ka nxjerrë udhëzimet kurrikulare<sup>19</sup> për mësuesit mbi mësimin e lëndës TIK, duke paraqitur edhe modele apo formate për të integruar njohuritë TIK edhe në lëndë të tjera, si gjuha, shkenca, histori, etj. Ky material i nxit mësuesit që të përdorin mjete të ndryshme teknologjike për të komunikuar me nxënësit e tyre dhe për të zhvilluar lëndën, si faqe interneti, blogje, chat, forume, etj, duke promovuar metoda më interaktive. Udhëzimet gjithashtu përmendin edhe standardet e TIK-ut të UNESCO-s mbi nivelin e njohurive që duhet të zotërojë një mësues në kuadër të kompetencave profesionale dhe njohurive mbi teknologjinë për sa kohë që japin këtë lëndë.

Përveç sfidave të mësipërme që ka sistemi arsimor në Shqipëri, viti 2020 e vështirësoi edhe me tej situatën, ku për shkak të kushteve të diktuara nga pandemia COVID-19, mësimi në shkollat e ciklit parauniversitar dhe universitete u ndërpre dhe kaloi online. Për t'iu përgjigjur kushteve të reja, e gjendur edhe e papërgatitur për mësimin online, Ministria e Arsimit në Bashkëpunim me Radio Televizionin Publik Shqiptar krijuan hapësirën televizive RTSH-Shkollë, që u mundësonte nxënësve të ndiqnin mësimin nëpërmjet televizionit, shërbim që vazhdon ende të jetë aktiv. Përpos RTSH shkollë, një nismë tjetër që u përkrah nga ana e Ministrisë së Arsimit ishte edhe platforma akademi.al, një platformë e krijuar rishtazi dhe që ofron mësim të regjistruara, ngjashëm me ato të transmetuara në RTSH. Nga ana tjetër, një platformë e avancuar dhe mjaft e konsoliduar në ofrimin e shërbimeve arsimore online është *schoolme.education*, e cila ofron programin e klasave të 9-ta të paraqitur në mënyrë audiovizive, nëpërmjet animacioneve. Kjo platformë private

---

<sup>19</sup> <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2019/01/TIK-3.pdf>

është pilotuar në 35 shkolla në Shqipëri, por gjithashtu është në përdorim në disa biblioteka (Shkodër, Tiranë, Korçë) dhe ofron edhe trajnim për mësuesit për ta përdorur platformën në mënyrën më efektive të mundshme gjatë procesit të mësimdhënies. Universitetet, nga ana tjetër, përdorën platformat Zoom, Google Classroom, Microsoft Teams për të vazhduar programin me studentët. Pandemia nxorri në pah dhe theksoi edhe njëherë nevojën e institucioneve arsimore për të zhvilluar kapacitetet lidhur me përdorimin e teknologjisë në cilësi të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

## EMI NË ARSIMIN UNIVERSITAR

Në kuadrin e programeve akademike në nivel universitar nuk ka një lëndë që ofron formim të posaçëm lidhur me konceptin kompleks të EMI-t, por në departamentete të ndryshme të fakulteteve të edukimit, gazetarisë dhe shkencave sociale studentët marrin një formim të përgjithshëm në komunikim, gazetari, etj.

Këtu përmendim për shembull, Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin Histori-Filologji/UT që formon studentë në gazetari arti dhe kulture, gazetari politike, gazetari ekonomike dhe gazetari e përgjithshme. Sipas përgjegjësit të departamentit, këto kurrikula janë fleksibile dhe me një fokus parësor në gazetari.

Programi i Masterit Shkencor të Komunikimit për Ndryshim Social dhe të Sjelljes, ofruar nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale/UT ka një kurrikul që përfshin edukimin për median, audiencën dhe përdorimin e masmedias për aktivizëm social dhe ndryshime pozitive në shoqëri, duke kombinuar kështu elementë të informimit, medias, komunikimit dhe qytetarit aktiv.



Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës ofron programin “Multimedia dhe Televizion Digjital” në nivelin Bachelor. Programi ka si qëllim edukimin e studentëve lidhur me produksionet multimediale, duke ofruar kompetenca për të punuar në detyrat e produksionit dhe post-produksionit në fushën multimediale dhe televizive dixhitale që janë të nevojshme për të përmbushur nevojat e sektorit publik dhe privat të nevojshme në zhvillimin dinamik të teknologjive në fushën e medias. Ky program ofron specialitete të teknologjive multimediale dhe të televizionit dixhital duke kombinuar njohuritë bashkëkohore me studime teorike dhe praktike bazuar në përvojën shumëvjeçare në këtë fushë.

Universiteti Aleksandër Xhuvani lidhur me edukimin mediatik thekson nxitjen e mendimit kritik, si edhe përmirësimin e aftësive për të prodhuar përmbajtje audiovizive që përcjellin mesazhe.

Universiteti Bedër, është përqendruar në reformimin e kurrikulës për EMI-n, qasjen teorike dhe orientimin praktik duke pasur në fokus gazetarinë investigative. Por gjithashtu ofron programe për formimin në multimedia dhe dizajn grafik të studentëve, si edhe programe në komunikim marketingu, një pjesë e lëndëve të të cilit janë të lidhura ngushtë me konceptet e EMI-t (strategji kreativiteti, aplikacione multimediale, marketing digjital, etj.)

Ndonëse kurrikulat nëpër universitete kanë një fokus të mirëpërcaktuar që anon herë nga gazetaria, herë nga komunikimi, në terma afatgjatë është e nevojshme që politikat për EMI-n të përfshijnë edukimin për median dhe informacionin në universitete. Kjo të bëhet nëpërmjet ndërhyrjeve që trajtojnë EMI-n si koncept kompleks dhe ndërdisiplinar për të mos lënë pas edhe ata studentë që tashmë janë në auditore, një pjesë një pjesë e të cilëve pas diplomimit do të jenë mësuesit e arsimit para-univeritar.

***Ndërhyrjet EMI në nivel universitar të planifikohen në tre nivele: 1) operacional (ku të përfshihet promovimi, ndërgjegjësimi 2) analitik (të menduarit kritik, aftësitë analizuese, verifikimi i burimeve, reagimi ndaj fake news dhe propagandes etj.) dhe 3) krijues (zhvillimi i aftësive për të krijuar përmbajtje, si edhe për ta publikuar atë).***

## POLITIKAT QEVERTARE DHE OBJEKTIVAT RRETH TIK-UT DHE EMI-t

Dokumentacioni kryesor që shpalos politikat qeveritare rreth shoqërisë së informacionit është Strategjia Axhenda Digjitale e Shqipërisë (2015-2020), që pason Strategjinë Ndërsektoriale të Shoqërisë së Informacionit (2008-2013.) Kjo strategji e miratuar në vitin 2008 identifikoi nevojën për të futur TIK-un si lëndë në shkollë, por edhe nevojën për të informuar publikun e gjerë rreth mënyrave të gjetjes dhe përdorimit sa më efikas të informacionit, në një kohë kur po rritej ndjeshëm aksesit i popullatës në internet<sup>20</sup>.

“Masat e marra për futjen e edukimit për TIK në sistemin arsimor duhet të shoqërohen me plane edukimi për popullatën e gjerë që në një mënyrë ose tjetrën do të bëhet përdorues i informacionit apo i shërbimeve elektronike.”<sup>21</sup> Strategjia Axhenda Digjitale e pranon faktin se pavarësisht zhvillimeve dhe njëfarë përmirësimi të situatës, ka akoma shumë për të bërë rreth fushës së TIK-ut në sistemin arsimor.

Programi qeveritar për vitin 2013 e përmendte median si një nga fushat me prioritet, duke iu referuar lirisë së shtypit, funksionimit të radio-televizionit publik, autoriteteve rregullatore të pavarura dhe të drejtës së informimit, por

---

<sup>20</sup> Strategjia Ndërsektoriale për Shoqërinë e Informacionit (2008-2013.)

<sup>21</sup> Po aty.

nuk përmendte edukimin për median dhe informacionin. Politika dhe strategji të tjera mbi gjininë, mbrojtjen kundër diskriminimit, apo strategjitë mbi rininë, nuk e parashikojnë EMI-n si mjet për fuqizimin e qytetarëve dhe veçanërisht grupeve në rrezik. E vetmja referencë në këtë drejtim ka të bëjë me përdorimin e medias për fushata të ndërgjegjësimit publik kundër dhunës në familje, çështje të barazisë gjinore, diskriminim, etj.

## 4.2 EMI NË EDUKIMIN JOFORMAL

Sistemi arsimor dhe kurrikula bërthamë nuk përqëndrohen në mënyrë të veçantë në edukimin për median dhe informacionin. TIK është pjesë e kurrikulës, por theksi vendoset më shumë mbi avantazhet e përdorimit të teknologjisë së re dhe jo mbi njohuritë dhe aftësitë për të analizuar dhe vlerësuar informacionin që merret nëpërmjet këtyre teknologjive. Duke u nisur nga ky fakt, disa organizata të shoqërisë civile janë munduar të ndërmarrin iniciativa që të mbushin këtë boshllëk.

*Instituti Shqiptar i Medias (ISHM)* nisi në vitin 2010 një projekt për mbledhjen dhe shkëmbimin e eksperiencave rajonale në lidhje me iniciativat rreth edukimit për median dhe mënyrat e mundshme të përfshirjes së këtyre elementeve në programet arsimore. Janë hartuar dy tekste shkollore që mund të përdoren nga mësuesit për këtë qëllim, por njohja e medias nuk u përfshi zyrtarisht në kurrikulën bërthamë. Nuk pati as ndonjë hap të mëtejshëm në drejtim të arsimimit joformal, si trajnim ekstra-kurrikular, trajnim për mësuesit, etj. Por megjithatë, ky institut ka vazhduar të botojë libra dhe Manuale në lidhje me edukimin për median

dhe informacionin, ku më i fundit ka qenë “Gazetaria, Lajmet e Rreme dhe Dezinformimi” (2020).

Prej vitit 2018 ISHM ka zbatuar një projekt që përqendrohet te zhvillimi i komponentëve të ndryshëm të EMI, të tilla si: ndërtimi i një koalicioni të aktorëve qeveritarë, joqeveritarë dhe medias për të zhvilluar politikat për EMI, ndërtimin e kapaciteteve të organizatave jo-qeveritare në fushën e EMI, ndërgjegjësimin publik për rolin e medias dhe elementë të EMI nëpërmjet fushatave me gazetarë në media sociale dhe në shkolla të ciklit të ulët e të mesëm, etj. Po kështu, ISHM ka mbështetur tetë organizatat të shoqërisë civile që të zhvillojnë projektet dhe kapacitetet e tyre në fushën e EMI, nëpërmjet një skeme të granteve të vogla. Po kështu, janë botuar disa manuale që lidhen me EMI si materiale ndihmës për mësuesit dhe gazetarët, por edhe botime të lidhura me llojet e dezinformimit dhe mënyra se si të dallohen lajmet e rreme apo keqinformimi. Gjithashtu, ISHM-ja zhvillon edhe kurse trajnimi për studentët e gazetarisë dhe për gazetarë të rinj, për të përmirësuar aftësitë e tyre në lidhje me teknologjinë digjitale, të lidhura sidomos me verifikimin e informacionit online.

Një angazhim të ngjashëm ka ndërmarrë edhe qendra **Media Aktive**, që është përfshirë në trajnimin e të rinjve për të krijuar përmbajtje mediatike, duke i mësuar normat profesionale dhe aftësitë teknike. Gjithashtu, **Fondacioni Soros ka organizuar projektin RRATHË**, duke ftuar të rinj që të prodhojnë filma dokumentarë mbi çështje me karakter social.

Nga 2016 e deri më sot, disa organizata të tjera kanë kontribuar në fushën e edukimit për media dhe informacion, ndonëse këto kontribute kanë qenë në kuadër të projekteve të caktuara dhe nuk kanë një vazhdimësi në terma afatgjatë.

Më konkretisht, një prej këtyre organizatave është **Instituti për Demokraci Media dhe Kulturë (IDMC)** që pjesë të misionit të saj ka mbështetjen e të rinjve në lidhje me edukimin mediatik. Në këtë drejtim, IDMC-ja ka hartuar disa manuale, si “Manuali i Historisë Gojore”, “Manual për Aftësimin Mediatik në Shkollë”, “COVID-19: Manual për propagandën”, por gjithashtu ka zhvilluar edhe trajnime e konkurse që në thelb kanë zhvillimin e aftësive të të rinjve për të krijuar përmbajtje mediatike.

Organizata të tjera, kryesisht ato që merren me mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve, janë angazhuar në mbrojtjen e fëmijëve online, duke krijuar një aleancë dhe platformë kombëtare për sigurinë e fëmijëve në internet, me bashkëpunimin edhe të institucioneve qeveritare shqiptare – në platformën [www.isigurt.al](http://www.isigurt.al). Kjo iniciativë ka si qëllim kryesor mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimet, por nevojitet që me tej t’u shpjegohet atyre se si të përdorin mediat dhe informacionin në mënyrë të sigurt, por efikase.

**Qendra për të Drejtat e Fëmijëve (CRCA)** në dy projekte të zbatuara së fundmi ka pasur edhe komponentë të edukimit dhe prodhimit të mediatike, ku ata vetë kanë qenë prodhues të përmbajtjes së shkruar dhe/ose audiovizive. **Observatori për të Drejtat e të Rinjve dhe Fëmijëve**, lidhur me EMI-n, ka realizuar një studim mbi “Etikën e videove muzikore dhe ndikimin e tyre tek adoleshentët”.<sup>22</sup>

**Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ)** me mbështetjen e UNICEF është duke ofruar kurse për edukimin digjital, me fokus në rritjen e aftësive të fëmijëve nga komunitete të marginalizuara për të përdorur pajisjet

---

<sup>22</sup> [https://observator.org.al/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-final-anglisht\\_5.12.2019.pdf](https://observator.org.al/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-final-anglisht_5.12.2019.pdf)

teknologjike dhe internetin, njëkohësisht duke qenë të sigurtë online. Produkti i kësaj nisme do të jetë edhe hartimi i një kurrikule të posaçme për edukimin digjital të fëmijëve.

**Qendra ABC Tirana Club** - një nismë studentore që synon të rigjallërojë jetën dhe aktivizimin rinor, mes të tjerave edhe përmes edukimit për median dhe informacionin të këtij target-grupi. Në këtë drejtim, qendra ka zbatuar një projekt të financuar nga BE “Kuptimi dhe vlerësimi në mënyrë kritike i përmbajtjeve mediatike nga studentët”, me qëllim nxitjen e të menduarit kritik mbi atë që lexojnë, shikojnë, dëgjojnë për të kuptuar dhe seleksionuar ato përmbajtje të cilat janë të pabazuara në fakte.

**Qendra H.A.N.A (Hand in Hand Against Nation Apathy)**, organizatë rinore që ushtron veprimtarinë e saj në qytetin e Lezhës është duke zhvilluar kursin “Tregimtari dhe multimedia”, ku të rinjve u jepet mundësia të trajnohen mbi çështje të EMI-t dhe të zhvillojnë mandej aftësitë e tyre të të menduarit kritik, por edhe të jenë “qytetarë-gazetarë” duke kontribuar aktivisht me krijim përmbajtjesh për të shprehur mendimet dhe nevojat vetjake dhe komunitare.

Organizata mediatike **“Faktoje.al”**, merret me edukimin qytetar kryesisht mbi ligjin për të drejtën e informimit, verifikimin e fakteve, edukimin për dallimin dhe shmangien e propagandës, si edhe fushata ndërgjegjësuese për disinformimin, lajmet e rreme dhe propagandën. Në mënyrë të veçantë trajnon studentët e gazetarisë, por ka edhe në fokus të rinjtë dhe publikun e gjerë. Mënyrat sesi Faktoje.al nxit krijimtarinë mediatike dhe mendimin kritik është nëpërmjet blogut, studimeve dhe ofrimit të hapësirës së raportimeve nga ana e qytetarëve.

Po me fokus gazetarinë, **Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore**, ofron edukim dhe trajnime për gazetarët dhe studentët e gazetarisë për lajmet e rreme, lirinë e shprehjes, aksesin në media të grupeve të marxhinalizuara, multimedia dhe gazetarinë e lëvizshme. Një projekt i tyre është MOJO Albania: Gazetaria e lëvizshme si një metodë për inovacion që synon të rrisë kapacitetet e gazetarëve dhe studentëve të gazetarisë në fushën e gazëtarisë së lëvizshme dhe prodhimin e lajmeve përmes këtyre metodave bashkëkohore.

Nga ana tjetër, vëmendje të veçantë vazhdon edhe merr **edukimi dhe aftësimi digjital** kryesisht me një fokus të veçantë tek teknologjia e informacionit dhe komunikimit. Kështu, ofrohen trajnime për fëmijë dhe të rinjtë në fushën e kodimit, programimit, robotikës dhe inteligjencës artificiale. Programe në këtë drejtim janë “Coding for Albania” dhe “Coding Hour” zbatuar nga **Alpha Plan** për nxënësit nga klasa e 6-9; **Smart-Gigs** (për fëmijët 7-13 vjeç); **Bibliotech-nismë e bashkisë Tiranë dhe UNICEF** për të shndërruar bibliotekat e 4-shkollave në Tiranë në inkubatorë për zhvillimin e aftësive digjitale të fëmijëve (digital literacy) dhe programet e ofruara nga Ambasada Amerikane, nëpërmjet Qendrave American Corner- të cilat ofrojnë programe të përditshme arsimore dhe kulturore për grupmosha të ndryshme, si edhe klasa teknologjie dhe inovacioni, klube (Klubi i Leximit, Klubi i Fëmijëve, Klubi i Dramës, Klubi i Librit); shfaqje filmi / Ora e Filmit, etj; **Qendra TUMO**, qendra për edukimin kreativ e inaguruar së fundmi në Tiranë ofron programe për fëmijët 12-18 vjeç në 8 fusha kryesore: kodim, programim, grafik dizajn, bërje filmi, muzikë, lojra, robotikë, modelim 3D. Fokusi i këtyre programeve është nxitja e të menduarit kritik, rritja e aftësive kërkimore dhe për zgjidhjen e problemeve.

Përpos projekteve për EMI-n në nivel vendor apo kombëtar, përpjekje janë duke u bërë edhe në nivel rajonal, nga aktorë ndërkombëtarë. Vlen të përmendim këtu ***Balkan Voices Project, një projekt dy-vjeçar (2020-2022), i cili zbatohet nga Canal France International (CFI)***, agjencia franceze e zhvillimit të mediave e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Nëpërmjet këtij projekti të zbatuar në gjashtë vendet e Ballkanit synohet të nxitet tek të rinjtë e shkollave të mesme mendimi kritik, si edhe aftësitë për të prodhuar përmbajtje digjitale, audivizuale, kompetenca mbi kontrollin e burimeve, identifikimin e influencësve dhe zhvillimin e degëve të artit, etj.

Në dallim nga Balkan Voices që targeton të rinjtë, projekti rajonal ***“Media për qytetarët – Qytetarët për Median” financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar në Shqipëri nga Instituti Shqiptar i Medias*** do të vazhdojë deri në 2021 dhe ka në thelb të tij zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile për të përmirësuar Edukimin mbi Median dhe Informacionin në Ballkanin perëndimor. Në këtë drejtim, projekti ka mbështetur disa nisma afatshkurtra që kontribuojnë për këtë qëllim.

UNICEF nga ana tjetër, në bashkëpunim me ICT Labs janë duke zbatuar në Shqipëri ***programin social rinor PONDER***, që synon të nxisë tek të rinjtë e moshës 14-21 vjeç aftësinë e të menduarit kritik veçanërisht në lidhje me informacionet që marrin nga të gjitha llojet e mediave. Ponder realizohet përmes një kurrikule e cila përmban: leksione, lojra dhe ushtrime ndërvepruese. Nxit aftësinë për të menduar në mënyrë kritike në lidhje me informacionet që merren në media. Përmirëson aftësitë e shkrim leximit kritik në media përmes mentorimit të vazhdueshëm. Aftëson të kuptuarit dhe



të sfiduarit e informacioneve subjektive. Pjesë e kurrikulës së Ponder është: përdorimi i kritik i EMI-t; diversiteti i mediave, pozicioneve dhe përvojave, leximi i imazheve si edhe rritja përmes të menduarit kritik mbi median dhe informacionin.

Katër vite pas nisjes së këtij studimi bazë, vihet re që nevoja për edukimin për median dhe informacionin është njohur dhe ka filluar të tërheqë vëmendjen e aktorëve të ndryshëm. Fakti që ka nisma, ndonëse sporadike dhe aftashkurtra, është një tregues pozitiv në këtë drejtim. Megjithëse nismat janë prezente, mungesa e organizatave dhe shoqatave të forta në nivel komunitetesh në fushën e arsimit, medias, dhe informacionit, ka penguar zhvillimin e mëtejshëm të arsimimit joformal në fushën e EMI-t.

Nga kërkimi që është bërë, vihet re që nismat dhe kontributi i dhënë për EMI-n në edukimin joformal është afatshkurtër, sporadik dhe i pakoordinuar mes aktorëve kryesorë. Këto nisma janë të përqendruara kryesisht tek gazetaria, krijimtaria multimediale, aftësimi digjital tek fëmijët dhe të rinjtë, mirëpo ende nuk ka një kontribut të mirëfilltë për EMI-n sikurse përkufizohet nga UNESCO.

## KODI I ETIKËS DHE KËSHILLI I ANKESAVE

Kodi i parë i Etikës u hartua për herë të parë në vitin 1996 nga Instituti Shqiptar i Medias në bashkëpunim me dy shoqatat më të mëdha të gazetarisë në atë kohë, por nuk pati ndonjë miratim apo adoptim zyrtar të këtij Kodi. Në një përpjekje tjetër në vitin 2006 Kodi i Etikës u pëmirësua dhe u rifreskua me përpjekjet e përbashkëta të Institutit Shqiptar të Medias dhe një grupi ekspertësh të medias. Gjithashtu, u analizua edhe mundësia e krijimit të një instrumenti apo institucioni vetërregullues, bazuar dhe në modelet e përdorura nga vende të tjera. Asokohe u mor mendimi i pronarëve të mediave kryesore në vend, redaktorëve,

ekspertëve të medias dhe gazetarëve. Megjithëse shumica ishte dakord në parim, aktorët kryesorë të medias në vend hezituan që të mbështesnin krijimin e mekanizmave vetërregulluese që duhet të mbikqyrnin zbatimin e rregullave të Kodit dhe të merrnin vendime që do të respektoheshin nga të gjitha organet e medias.

Rishikimi i kodit u bë sërish në 2018 nga një grup ekspertësh nën udhëheqjen e Institutit Shqiptar të Medias, si dhe u hartuan disa udhëzime për të mbuluar sjelljen etike në median online. Kodi i ri i Etikës përcakton të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve gjatë punës së tyre të përditshme dhe paraqet këndvështrimin e tij mbi rolin që duhet të luajë shtypi dhe gazetaria e lirë në shoqëri. Ky kod ka një përqsasje të ngjashme me rregulloret etike të vendeve të tjera për sa i përket çështjeve që merr në shqyrtim, si saktësia në raportim, ndarja e faktit nga opinionet, respekti për minorenët, viktimat dhe personat në nevojë, mbrojtja e pavarësisë redaksionale, shërbimi ndaj interesit publik, respektimi i parimit të pafajësisë pa u shpallur fajtor, e drejta e replikës dhe përgënjeshttrimit, ndarja e qartë e përmbytjes redaksionale nga reklamat, respektimi për jetën private, respektimi i të drejtës së autorit, etj.

Në vitin 2017 Instituti Shqiptar i Medias mblodhi së bashku një grup ekspertësh për rishikimin e Kodit dhe hartimin e Udhëzimeve Etike për Gazetarinë Online. Të dyja këto dokumente kaluan në proces konsultimi me komunitetin mediatik. Përveç Kodit të Etikës janë hartuar edhe rregullore apo udhëzime për sektorë të veçantë të gazetarisë, si gazetaria investigative, raportimi mbi viktimat e trafikut, raportimi mbi minorenët, raportimi mbi grupet në nevojë, raportimi mbi zgjedhjet, etj. Edhe në këto raste zbatimi i rregullave etike i lihet në dorë gazetarëve dhe ndërgjegjes së tyre dhe nuk vendosen penalizime për shkelje.

Krijimi i Këshillit të Medias në vitin 2015 nga një grup gazetarësh, u mbështet nga Këshilli i Evropës. Qëllimi i tij ishte që të ndikonte në përmirësimin e standardeve profesionale në gazetari nëpërmjet respektimit të rregullave të Kodit të Etikës. Deri tani ky këshill ka hapur zyrën e vet dhe ka zgjedhur një bord që shqyrton ankesat e publikut.

Gjithashtu një këshill ankesash funksionon pranë rregullatorit, Autoritetit të Mediave Audiovizive, që merr në shqyrtim ankesat që vijnë nga institucionet publike, OJQ-të dhe qytetarët, që deri tani kryesisht kanë qenë në lidhje me raportimin e të miturve dhe shkëlqen e dinjitetit njerëzor. Ankesat mund të gjenden të publikuara tek Buletini i Ankesave në faqen zyrtare të AMA-s. Fakti që ankesa vazhdojnë dhe dërgohen nga subjekte të ndryshme për sa i përket programeve televizive dhe përmbajtjeve të tyre që çënojnë rregullat etike dhe kodin e transmetimit, është një tregues që këshilli i ankesave ka qenë dhe vazhdon të jetë i domosdoshëm për t'i dhënë zë qytetarëve në këtë drejtim, si edhe për të shtuar përgjegjësinë për respektimin e rregullave nga ana e OSHMAV-ve. Megjithëse, ende nuk reflektohet ndikimi i tij në vetë-rregullimin e medias në vend dhe për këtë gjë do duhet ende kohë.

## SEKTORI PRIVAT DHE EMI

Sektori privat ka dhënë kontributin e tij këto vitet e fundit në sistemin arsimor në kuadër të edukimit për median dhe informacionin. Në vitin 2016, Ministria e Inovacionit, në bashkëpunim me ALMOOC, Platformën Shqiptare të Orës së Kodimit, zbatoi një projekt pilot të një kurrikule që përfshinte edhe njohuri bazë të kodimit, në një iniciativë të sponsorizuar nga Microsoft. Projekti krijoi një platformë arsimore online “që bashkëpunon me profesorë të dalluar të botës shqiptare

për t'u ofruar klasa online të gjithëve falas.”<sup>23</sup> Lëndët që jepen në klasat online përfshijnë subjekte që jepen në të gjitha shkollat e tjera: Anglisht, Matematikë, Fizikë, dhe Kimi, si dhe Kodimi dhe TIK si lëndë profesionale.

Platforma Schoolme.education<sup>24</sup>, themeluar në 2014, ofron digjitalizimin e teksteve shkollore për klasat 1-9 dhe është pilotuar në 35 shkolla në Shqipëri. Nëpërmjet kësaj platforme, duke u abonuar përkundrejt një pagese simbolike, nxënësit, prindërit dhe mësuesit mund të hyjnë në website dhe të ndjekin programet lëndore, sipas klasave përkatëse. Tekstet mbi të cilat SchoolMe e mbështet punën janë ato të miratuara zyrtarisht nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Për nga mënyra e paraqitjes së mësimëve, nëpërmjet animacioneve, kjo platformë ka sjellë një risi në arsimin shqiptar.

Akademi.al<sup>25</sup>, themeluar në fund të vitit 2019 u mbështet nga ana e MASR-së duke u prezantuar si partneri zyrtar për ofrimin e shërbimeve online në përgjigje të situatës së krijuar nga pandemia. Shërbimet që kjo platformë e krijuar rishtazi ofron janë transmetimi në website i mësimëve audivizive të regjistruara nga mësuesit e lëndës përkatëse në modelin tradicional të mësimdhënies. Materialet e tyre aksesohen nga platforma dhe në Youtube dhe përmbajnë lëndët e ciklit parauniversitar (fillor dhe të mesëm) që ofrohen pa pagesë pas regjistrimit në platformë.

---

<sup>23</sup> <http://almooc.com/rreth-nesh>

<sup>24</sup> <https://www.schoolme.education/landing/>

<sup>25</sup> <https://www.akademi.al/>

### 4.3. EMI NË EDUKIMIN INFORMAL

Edukimi informal është nxënia në jetën e përditshme, në familje, në vendin e punës, në komunitet, si dhe nga interesat dhe aktivitetet e individëve<sup>26</sup>. Sidoqoftë, është e vështirë të flitet për peshën që zë edukimi informal dhe rëndësinë e edukimit të popullatës për median dhe informacionin pa përcaktuar më parë nëse ka një bazë të shëndoshë për akses të lirë dhe të bollshëm në media, si dhe përçuesit e informacionit.

Legjislacioni shqiptar ka ligje të veçanta që garantojnë lirinë e shprehjes, si Ligji i Shtypit, dhe Ligji për Mediat Audiovizive.

Në vitin 2012, Shqipëria kreu një reformim të përgjithshme të ligjeve për shpifjen në planin penal dhe civil, duke i afruar shumë më tepër me standardet demoratikë evropiane. Burimet e informacionit gëzojnë mbrojtje dhe gazetarët nuk detyrohen me ligj që të zbulojnë burimet konfidenciale. Një ligj i ri mbi aksesin në informacion u aprovua në vitin 2014 dhe ai konsiderohet si një nga më të mirët në rajon.

Ligji për e-commerce u ndryshua së fundmi në vitin 2013, ndërkohë që tri vite më vonë pati propozime për ndryshime të legjislacionit për aktivitetet online (e-commerce), që mund të ndikojnë mbi funksionimin e organeve mediatike dhe ndërveprimin me përdoruesit, por këto amendamente janë akoma në diskutim e sipër. Në përgjithësi legjislacioni garanton lirinë e shprehjes, duke përfshirë edhe lirinë e medias, në një nivel të kënaqshëm.

Vitet e fundit ka patur disa përpjekje për të miratuar një ligj për mediat online duke patur parasysh ankesat e shumta

---

<sup>26</sup> <http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002163/216360e.pdf>

në lidhje me shkeljet e etikës<sup>27</sup>. Pas një procesi të debatuar gjatë, parlamenti aprovoi një ligj të tillë në fund të vitit 2019, por që u përball me kundërshtime të forta nga organizatat e medias dhe grupet e të drejtave të njeriut. Presidenti i Shqipërisë, ktheu për rishqyrtim në parlament ndryshimet në ligj me arsyetimin se ai bie në kundërshtim me parimet themelore kushtetuese të ndërtimit të një shteti demokratik, sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit. Pati kritika se ligji i jepte entit rregullator kompetenca thuajse gjyqësore për të vendosur sanksione kundër organeve mediatike, duke lënë të nënkuptohet se Shqipëria kishte bazë ligjore të mjaftueshme për të zgjidhur raste ku organet mediatike shkelin të drejtat e te tjerëve. Në këtë kontekst, ka precedentë të gjykimit të rasteve të tilla në gjykatat shqiptare<sup>28</sup>. Për t’iu përgjigjur këtyre kundërshtimeve dhe kritikave ndaj ligjit nga organizata ndërkombëtare, Këshilli i Evropës vendosi që të marrë mendimin e Komisionit të Venecias mbi këtë ligj.<sup>29</sup> Opinioni përfundimtar i Komisionit, që u botua në qershor 2020, tha se ndryshimet në legjislacion “nuk mund të adoptohen në formën aktuale. Ligji vuan nga paqartësia dhe do të ketë një efekt negativ, duke frenuar lirinë e diskutimit dhe fjalën politike në sektorin e internetit të medias shqiptare.”<sup>30</sup> Vlen për t’u theksuar se që nga ai moment ligji me ndryshimet nuk është sjellë më në vëmendje.

---

<sup>27</sup>Instituti Shqiptar i Medias, “Legjislacioni mbi mediat online dhe vetërregullimi” 2016.

<sup>28</sup> <http://www.institutemedia.org/2020/01/11/international-and-albanian-media-freedom-organizations-strongly-criticize-the-two-draft-laws-on-online-media/>

<sup>29</sup> <https://a2news.com/2020/01/22/paketa-antishpifje-kie-con-draftin-ne-venecia-ps-rrezon-presidentin/>

<sup>30</sup> [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2020\)013-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2020)013-e)

## PRANIA E ORGANEVE MEDIATIKE DHE AKSESI NË INFORMACION

Qytetarët shqiptarë kanë akses në një numër të madh organesh mediatike. Nuk ka akoma të dhëna zyrtare mbi numrin e shtypit të shkruar, apo mbi numrin e kopjeve që hidhen në qarkullim. Aktualisht, ka më shumë se 150 gazeta të përditshme, si të natyrës së përgjithshme ashtu dhe me përmbajtje tematike, si p.sh. gazeta sportive.

Ligji Nr.9472 Për Transmetimet Digjitale/Numerike në Republikën e Shqipërisë miratuar në vitin 2007, së bashku me Strategjinë<sup>31</sup> kishin për qëllim të adresonin çështje që kishin të bënin me aksesin dhe përballueshmërinë në kuadër të kalimit në transmetime digjitale. Ligji specifikon se operatorët duhet të përdorin dekodera universale që u japin akses abonentëve në të gjitha programet pa pagesë.<sup>32</sup> Strategjia për Kalimin në Transmetime Digjitale, dokumenti zyrtar që orientoi kalimin në transmetime digjitale, u aprovua vetëm në vitin 2012. Gjatë kësaj kohe, një platformë digjitale private u hap dhe u mbyll, ndërsa dy platforma komerciale të tjera vazhdojnë të funksionojnë. Duke patur parasysh këto zhvillime dhe e gjendur përballë presionit të platformave digjitale ekzistuese që kërkonin të mbronin investimet e veta, Strategjia përcaktoi se licencat për rrjetet kombëtare digjitale do të shpërndaheshin sipas procedurave 'beauty contest', që do të thoshte se në konkurrim do të merrnin pjesë platformat ekzistuese dhe ato media elektronike që konsideroheshin si operatorë me përvojë. Kalimi në transmetimin digjital në

---

<sup>31</sup> Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike (2012)

<sup>32</sup> OSFA (2012) Zhvillimi i Medias Dixhitale: Shqipëria. Raporti për Shqipërinë. Faqe 77

Shqipëri është në zbatim e sipër dhe Strategjia e Kalimit në Teknologji Digjitale i ka caktuar radio televizionit publik detyrën që të ndërtojë dy platforma digjitale kombëtare, një pjesë e së cilës do të shërbejë për radio televizionet private.<sup>33</sup>

Në përgjithësi, rrjedha e informacionit si nga burimet tradicionale të informimit ashtu dhe nga faqet online, rezulton në një shumëllojshmëri të pasur burimesh informacioni dhe aksesit ndaj këtyre burimeve është i pakufizuar, ndërkohë që edhe çmimet konsiderohen në përgjithësi të lira dhe të përballeshme. Sipas entit rregullator të komunikacioneve elektronike, niveli i përhapjes së internetit në fund të vitit 2019 ishte 75 për qind<sup>34</sup>. Po kështu, shqiptarët janë përdorues të rregullt të rrjeteve sociale, veçanërisht në Facebook, me rreth 1.4 milionë faqe, apo një nivel përhapje prej 49 për qind, deri në fund të muajit janar 2020<sup>35</sup>.

## ROLI I BIBLIOTEKAVE MBI EDUKIMIN PËR INFORMACIONIN

Bibliotekat mund të luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e edukimit të medias dhe informacionit. Sidoqoftë, roli dhe misioni i tyre duhet të rishqyrtohet në raport me procesin e digjitimit të informacionit dhe shërbimeve të reja që mund të ofrohen në këtë drejtim, për t'iu përshatur sa më shumë nevojave të reja që kanë qytetarët në epokën digjitale.

Sipas legjislacionit bibliotekat janë pjesë e sistemit kombëtar të informacionit. Ligji i konsideron ato si institucione kulturore dhe informative, që realizojnë akses

---

<sup>33</sup> Instituti Shqiptar i Medias (2018) Media

<sup>34</sup> Statistika Botërore Interneti, <https://www.w.com/europa2.htm#al>

<sup>35</sup> Po aty.



në informacion, në cilëndo formë që ai të jetë depozituar<sup>36</sup>. Rrjeti kombëtar bibliotekar përbëhet nga tërësia e bibliotekave në vend. Ministria e Kulturës harton dhe ndjek zbatimin e strategjisë dhe politikave të zhvillimit në fushën e bibliotekave.

Institucioni kryesor në fushën e bibliotekave është Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë<sup>37</sup>, e themeluar në vitin 1920, në Tiranë. Biblioteka ka funksione dhe sektorë të shumtë, por roli i Sektorit të Informatikës dhe Teknologjive të Reja është veçanërisht i rëndësishëm për sa i përket informimit dhe afrimit të publikut me median dhe informacionin, pasi mundëson, orienton dhe organizon integrimin e teknologjisë së informacionit në punën e përditshme të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Baza e të dhënave të BKSH-së përmban 447.336 materiale bibliotekare (libra, artikuj, harta, dorëshkrimeve etj.) që mund të kërkohen online dhe mbi 265.000 faqe librash, revistash, dorëshkrimesh, antikuarësh, hartash, që janë tashmë të digjituara dhe të aksesueshme online. Prej marsit 2020, kërkesat e përdoruesve për anëtarësim në BKSH dhe kërkesat e përdoruesve për përdorim të materialeve bibliotekare brenda mjediseve të saj ofrohen nëpërmjet portalit e-Albania, duke lehtësuar në këtë mënyrë procesin e anëtarësimit të lexuesve, si edhe për bërjen e kërkesave për studimin e materialeve në sallë në distancë.

---

<sup>36</sup> Përveç Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, legjislacioni rregullon edhe funksionimin e bibliotekave publike, që kanë varësi administrative nga qeverisja qendrore apo vendore dhe profesionale nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Sistemi kombëtar bibliotekar përfshin 105 biblioteka (55 në kryeqytet dhe 50 në qytetet e tjera në vend). Në të bëjnë pjesë: Biblioteka Kombëtare, bibliotekat publike, bibliotekat universitare (shtetërore e private), bibliotekat e veçanta (Biblioteka e Parlamentit, Biblioteka e Akademisë së Shkencave etj.).

<sup>37</sup> <https://www.bksh.al/>

Përveç mbledhjes, ruajtjes, përpunimit dhe vënies në shërbim të publikut të botimeve në shqip apo gjuhë të huaj, krijimit të katalogëve manualë e elektronikë, hartimit të bibliografive etj., Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë luan edhe rolin e Qendrës së Trajnimit Bibliotekar, duke trajnuar të gjithë punonjësit e bibliotekave në vend.

Po ashtu, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë ka “Programet e Aftësisimit në Informacion” që targetojnë studentë, nxënës, fëmijë dhe përdorues të tjerë të kategorive të ndryshme. Për studentët ky aftësim përfshin njohuri mbi përdorimin e: burimeve online, OPAC- ut (kërkim i thjeshtë/i avancuar/tronkimi etj.), e-bibliografive, Bibliotekës Digjitale, si dhe orientimin e tyre në kërkimin shkencor dhe bibliografik. Ndërsa *Aftësimi në Informacion* për fëmijët bëhet nëpërmjet nismave “Miqte e Librit” dhe “Edukimi përmes kulturës”, ku fëmijëve iu mësohet hap pas hapi si duhet të veprojnë për t’u regjistruar në bibliotekë, për të kërkuar një informacion në plotësim të kërkesave të aspektit mësimor etj. *Klubi i Artit dhe Lexuesve të vegjël* janë të përfshira në modulën e *Aftësisimit në Informacion* për fëmijët e grupmoshës 6-10 vjeç. Vëmendje e veçantë i kushtohet aftësisimit të fëmijëve në përdorimin e pajisjeve teknologjike (amazon kindle, ipad, kompjuter, tablet), ku dallon klubi i teknologjisë për vajzat e moshave 13-17 vjeç që krijojnë aplikacione për zgjidhjen e problemeve sociale (GjejZa) apo *Klubi i Librit* për vajzat e moshave 16-20 vjeç. Ndërsa, moduli për nxënësit e shkollave të mesme, fokusohet në aftësimin e tyre për njohjen e koleksioneve bibliotekare, përdorimin e katalogëve elektronikë/manualë, orientimin për të gjetur literaturë shkollore në web, burime referuese etj.

Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë me programet e saj të *Aftësisimit në Informacion* iu adresohet të gjitha grupmoshave; ka qëndrueshmëri në ofrimin e këtyre trajnimeve, si dhe e ka

tashmë të konsoliduar strategjinë insitucionale për *Aftësimin në Informacion* duke luajtur një rol kyç në këtë drejtim.

Spektori i Bibliografisë Kombëtare, - pjesë e strukturës së Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, - është qendra e vetme bibliografike në të gjithë vendin. Që nga viti 1961 boton çdo muaj bibliografinë e artikujve të periodikut shqip, ku përshkruhen artikujt kryesorë të shtypit që botohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, e aksesueshme edhe online. Gjatë viteve të fundit, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë ka punuar për digjimin dhe publikimin online të librave antikuarë, dorëshkrimeve, hartave, organeve të rëndësishme të periodikut duke nisur nga fillimet e shtypit shqiptar, veprave të autorëve të traditës etj. Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë organizon edhe Shkollën Kombëtare të Bibliotekomomisë për të gjithë sistemin kombëtar bibliotekar, programi i së cilës përfshin edhe elemente të edukimit për median dhe informacionin<sup>38</sup>.

Në mënyrë që të nxisin interesin për të lexuar libra, sidomos tek të rinjtë, organizata të ndryshme dhe institucione qeveritare kanë nisur një sërë projektesh për këtë qëllim. Shqipëria Lexon (Albania Reads) është një nga projektet e para dhe kryesore në këtë drejtim e krijuar nga UNICEF, në bashkëpunim me subjekte të tjera private dhe shtetërore, me qëllim hapjen e bibliotekave të reja, apo pasurimin e fondit të librave në institucionet arsimore para-universitare nëpër të gjithë vendin.

Ministria e Kulturës ka organizuar, në bashkëpunim me shtëpi botuese dhe personalitete publike, aktivitete për të promovuar leximin e librave nga të rinjtë, si fushata "Takohemi për një libër," duke zhvilluar lexime publike dhe diskutime të hapura me personalitete të mirënjohura;

---

<sup>38</sup> Kurrikula përfshin lëndë, si: Organizimi i Informacionit, TIK, Biblioteka Digjitale, Shërbime bibliotekare për publikun.

fushata “Lexoj qytetin tim,” duke u krijuar mundësi nxënësve që të mësojnë gjëra të reja rreth qytetit të tyre nëpërmjet leximit të librave; fushata “Lexoju, që të lexojnë,” që ka të bëjë me takime midis artistëve shqiptarë dhe nxënësve të shkollave të mesme për të folur për librin; etj. Një tjetër projekt është edhe “Rijetëzimi i Bibliotekave,” nëpërmjet të cilit kjo ministri ka dhuruar 1,200 libra për gjashtë biblioteka të kryeqytetit. Po ashtu, Ministria e Kulturës mbështet projekte me fokus kulturor, por që kanë në thelb digjitalizimin dhe përdorimin e tij për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Në vitin 2019 u ngrit Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit (QKLL) që ka si mision ndjekjen dhe zbatimin e projekteve në fushën e librit, sipas programit qeverisës të ministrisë përgjegjëse për librin, duke synuar përhapjen e kulturës së leximit në të gjithë vendin, nxitjen e krijimtarisë, forcimin e rolit promovues dhe edukativ të bibliotekave dhe mbështetjen e projekteve për promovimin e letrave shqipe në tregun evropian dhe atë botëror.<sup>39</sup> Nga kjo qendër janë organizuar aktivitete dhe konkurse që promovojnë leximin dhe krijimtarinë letrare dhe artistike, sikurse “Libri i Karantinës”, etj.

## ROLI I MUZEVE DHE ARKIVAVE NË EDUKIMIN PËR INFORMACIONIN

Legjislacioni shqiptar njuh dhe rregullon funksionimin e muzeve publikë dhe privatë. Muzetë publikë mund të jenë nën mbikqyrjen dhe administrimin e Ministrisë së Kulturës, Akademisë së Shkencave, institucioneve të tjera publike, si dhe qeverive lokale. Megjithëse ligji e lejon dhurimin e fondeve

---

<sup>39</sup> <https://qkll.gov.al/rreth-qkll/vendimi-i-krijimit/>

apo donacioneve për sponsorizimin e muzeve, përfaqësues të administruesve të muzeve thonë se gati të gjithë muzetë publikë vuajnë nga mungesa kronike e fondeve.<sup>40</sup>

Ka disa arkiva publike në vend, më i madhi nga të cilët është Arkivi Qendror Shtetëror, ndërsa arkivat e tjera i përkasin institucioneve të veçanta, si Kuvendi, ministri të ndryshme, arkivat e gjykatave, etj. Sipas ligjit, informacioni i ruajtur në këto arkiva është i hapur për publikun, pa asnjë lloj diskriminimi dhe pa patur nevojë që të paraqitet ndonjë arsye për marrjen e informacionit<sup>41</sup>.

Ndonëse në parim informacioni i ruajtur në këto arkiva i jepet publikut sipas kërkesave, në respektim të plotë të ligjit, së fundmi ka marrë jetë një përjasje pro-aktive për ofrimin e shërbimeve në mënyrë digjitale, kështu Arkivi Qendror Shtetëror<sup>42</sup> ka futur në përdorim kartën elektronike të përdoruesve, si edhe ka bërë digjitalizimin e 130 mijë fotove dhe 12 mijë librave në arkivin e shtetit. Shërbimet që ofrohen online për studiuesit aktualisht përfshijnë Katalogun, Fototekën, Bibliotekën, mundësinë për të bërë kërkesa social-juridike online, si edhe mundësinë për kërkesë për restaurim të dokumentave<sup>43</sup>, si edhe Muzeun Virtual. AQSH-

---

<sup>40</sup> Gjatë viteve të fundit qeveria ka investuar në rinovimin e muzeve të vjetër (p.sh. Muzeu i Artit Mesjetar në Korçë) apo bashkëfinancimi për krijimin e muzeve të rinj (p.sh. Muzeu i Fotografisë “Marubi” në Shkodër.) Si rrjedhojë e debatit të përgjithshëm shoqëror dhe tendencës për të rishikuar historinë, si dhe nevojës për të zbuluar të vërtetën rreth regjimit komunist, janë hapur muze të rinj që tregojnë për jetën në diktaturë, dhe të tjerë janë në proces hapje (p.sh. dy muzetë Bunkart.) Sipas ligjit, muzetë duhet të ofrojnë çmime më të ulëta për kategori të veçanta njerëzish, ndërsa për shkollat hyrja është zakonisht e lirë

<sup>41</sup> Informacioni mohohet vetëm në raste kur nuk lejohet të bëhet publik nga ndonjë ligj tjetër, zakonisht kur informacioni është akoma i klasifikuar si sekret shtetëror.

<sup>42</sup> <https://arkiva.gov.al/>

<sup>43</sup> <https://restaurim.arkiva.gov.al/>

ja në bashkëpunim me media të ndryshme ka përgatitur reportazhe të shkurtra që synojnë të informojnë publikun mbi mënyrën sesi mund të aksesojnë shërbimet online dhe fizike të arkivave.

Padyshim ky është një hap pozitiv, por mbetet ende shumë për t'u bërë, pasi digjitalizimi i arkivave vazhdon të jetë problem serioz, veçanërisht për filmat e vjetër dhe materialet e vjetra të Radio Televizionit Publik, arkiva e të cilit ka patur rënie në cilësi me kalimin e viteve, ndonjëherë duke vënë në rrezik edhe vetë materialet që duhet të ruajë. Arkivi Shtetëror i Filmit ka filluar që të digjitalizojë gradualisht dhe të përmirësojë cilësinë e filmave të vjetër dhe aktualisht disa prej tyre mund të gjenden online në faqen e internetit të Arkivit. Megjithë sfidat që arkivat hasin në procesin e digjitalizimit, ato mbeten një insitucion kryesor që duhet të përfshihen në strategjinë për EMI-n në Shqipëri për tërësinë e informacioneve që zotërojnë dhe aksesin që duhet të sigurojnë për publikun dhe studiuesit.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) ndeshet me probleme serioze në shpërndarjen e filmit shqiptar, si edhe me mungesën e rrjetit të kinemave. Në këtë drejtim, ndonëse me fonde të kufizuara, QKK-ja ka financuar rijetësimin e kinemave në Vlorë dhe Gjirokastër. Në sferën e prodhimit, kjo qendër mbështet prodhimin e filmave dokumentarë, artistikë dhe vizatimorë, megjithatë problem tjetër pas prodhimit të tyre mbetet aksesin ndaj publikut. Këtu merr rëndësi bashkëpunimi me televizionet dhe detyrimi për transmetim i filmave shqiptarë, si një mënyrë për të garantuar aksesin e tyre tek publiku. Aktualisht në sistemin arsimor nuk ka një edukim të mirëfilltë mbi filmin. QKK kërkon që strategjia për EMI-n të përfshijë tematika të veçanta edhe për edukimin mbi filmin. Qendra ka realizuar botime si “Të dish të lexosh një film” dhe ka zhvilluar konkurse me shkollat.

Njëkohësisht ka mbështetur projektet për realizimin e 13 filmave të diplomave për studentët e Universitetit të Arteve.

Në kuadër të paktit për universitetin, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin, ka mbështetur projektin për krijimin e “Labororit të Regjisë së Filmit dhe TV” të Universitetit të Arteve që synon plotësimin e laboratorëve me infrastrukturën e nevojshme për të adresuar procesin mësimor dhe krijues me finalizim në produktet filmike të realizuara.

Nga kërkimet e bëra dhe informacioni i mbledhur nga intervistat rezulton që edukimi informal për median dhe informacionin kryhet nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, Muzeu Historik Kombëtar, Arkivi Qendror Shtetëror, Këshilli i Ankesave, etj. Këto insitucione e përqendrojnë EMI-n tek aksesin në informacion, ofrimi i shërbimeve digjitale, si edhe nxitja e leximit dhe rritja e numrit të frekuentuesve në institucionet përkatëse duke kontribuar kështu në disa elementë të përqasjes holistike të EMI-t.

## POLITIKAT DHE STRATEGJITË KUNDREJT EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMACIONIN NË SHQIPËRI

Shqipëria është ende pas në fushën e hartimit të politikave, strategjive dhe zbatimit të tyre në fushën e edukimit për median dhe informacionin. Megjithëse disa palë dhe aktorë janë munduar të merren seriozisht me aspekte të veçanta të edukimit për median dhe informacionin, ky proces është akoma në fazën fillestare dhe ka hasur në pengesa serioze, si reformat në arsim, niveli i ulët i përgatitjes së mësuesve, iniciativa tepër modeste nga OJQ-të në këtë fushë, mungesa e shoqatave të forta profesionale dhe organizatave komunitare, etj. Sidoqoftë, sa më shpejt të përfshihet në kurrikulat zyrtare,

apo iniciativa të tjera, koncepti i edukimit për median dhe informacionin, aq më mirë do të jetë për qytetarët shqiptarë, veçanërisht tani në epokën e ndryshimeve të rrufeshme në botën e informacionit dhe teknologjisë.

Bazuar në kontekstin shqiptar dhe analizën e situatës në lidhje me edukimin për median dhe informacionin në Shqipëri dhe duke ndjekur strategjinë konceptuale të UNESCO-s për edukimin për median dhe informimin, mund të propozohen disa orientime strategjike dhe objektiva për të zhvilluar më tej politikat dhe strategjitë në lidhje me edukimin për median dhe informimin në arsimin formal. Këto propozime do të diskutohen në konsultime në nivel kombëtar dhe më pas do të arrihet në rekomandimet përfundimtare.



# V

## OBJEKTIVAT E POLITIKAVE PËR EMI

- T'i japin përparësi Edukimit për Median dhe Informacionin në edukimin formal, joformal dhe informal në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria dhe krijimi i kulturës për median dhe informacionin.
- Programet për edukimin për median dhe informacionin në nivel universitar të ofrojnë arsimim specifik dhe trajnim të vazhduar për të përmirësuar njohjen me median dhe informacionin tek studentët dhe profesionistët e rinj.
- Programet për edukimin për median dhe informacionin në nivel para-universitar të ofrojnë arsimim specifik dhe trajnim të vazhduar për të përmirësuar njohjen me median dhe informacionin tek mësuesit dhe nxënësit.
- Programet EMI të hartohen në mënyrë të tillë që të mundësojnë përfshirjen sa më të gjerë të qytetarëve në këtë proces (pa dallim moshe, niveli arsimit, gjinie, statusi punësimi) duke përmirësuar marrëdhëniet e tyre me median dhe informacionin, si dhe duke ndihmuar kristalizimin e mendimit kritik në lidhje me to.

- Programet EMI të nxisin përmirësim të profesionalizmit në media dhe krijimin e organizmave vetë-rregulluese që do të ndihmojnë në procesin e edukimit të qytetarëve për median dhe informacionin.
- Programet EMI do të promovojnë vlerat e medias, arkivave, bibliotekave, muzeve dhe përçuesve të tjerë të informacionit për të përmirësuar gjithëpërfshirjen sociale, politikat anti-diskriminuese, dhe mungesën e zhvillimit në zona më mundësi të pakta ekonomike.

# VI

## **REKOMANDIME STRATEGJIKE PËR HARTIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR EMI-N**

Në vijim paraqiten një sërë rekomandimesh strategjike që adresojnë Edukimin për Median dhe Informacionin në tre nivele edukative, atë formal, joformal dhe informal. Rekomandimet janë bërë duke marrë në konsideratë nevojat aktuale të vendit tonë lidhur me EMI-n, por edhe reflektojnë sugjerimet e mbledhura nga aktorët kryesorë, që janë intervistuar dhe kanë marrë pjesë në takimet konsultuese kombëtare.

### **1. Rekomandime strategjike për EMI-n në edukimin formal (në nivel parauniversitar dhe universitar)**

Rekomandimet në sistemin arsimor formal përfshijnë rritjen e kapaciteteve të nxënësve dhe mësuesve në lidhje me EMI-n për ciklin parauniversitar, si edhe rritjen e njohurive dhe kompetencave EMI të studentëve dhe stafit pedagogjik për ciklin universitar. Ndërhyrja themelore e sugjeruar është integrimi i kurrikulës EMI në të dyja ciklet arsimore.

<b>Qëllimi:</b>			
<b><i>Rritja e kapaciteteve të nxënësve/studentëve dhe mësuesve/pedagogëve në Edukimin për Median dhe Informacionin përmes kurrikulës së integruar në sistemin formal të edukimit në ciklin parauniversitar dhe universitar</i></b>			
<b>Palët e interesuara:</b>			
<b><i>Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve; Ministria e Kulturës, ASCAP, Shkolla 9-vjeçare dhe të mesme; Insititucione kërkimore; Univeristetet publike dhe private</i></b>			
<b>OBJEKTIVA STRATEGJIKË</b>	Formulimi i një strategjie zyrtare dhe politikave që e trajtojnë EMI-n si koncept të gjerë dhe më pas zbatim i tyre.	Trajnimi i trajnuesve për EMI-n dhe kurrikulumet për të orientuar procesin e redaktimit të kurrikulave.	Hartimi i kurrikulave dhe udhëzimeve për profesionistë, sipas kurrikulës model EMI të botuara nga UNESCO dhe institucione të tjera të ngjashme.
	Hartimi i kurrikulës pilot EMI e përshtatshme për mësuesit e ciklit parauniversitar dhe stafin pedagogjik të ciklit universitar.	Mbështetje për trajnimet mbi EMI-n për stafin kërkimor në arsimin e lartë dhe institucione kërkimore.	Ofrimi i mundësive për edukim të vazhdueshëm për mësuesit dhe pedagogët që do të jenë përgjegjës për zbatimin e kurrikulës EMI.
	Rishikimi i kurrikulave në arsimin e nivelit të parë, të dytë, dhe arsimin të lartë për të përfshirë tematikat e EMI-t.	Integrimi i EMI-t në aktivitete ekstra-kurrikulare në shkolla për të plotësuar njohuritë që merren në klasa në arsimin formal. Për shembull grupe EMI; instalimi i një stacioni të vogël radio në bibliotekë; programe trajnimi për të rinj në media dhe biblioteka.	Hartimi i programeve universitare me orientim praktik dhe planifikimi i ndërhyrjeve të EMI-t në tri nivele: 1) operacional, 2) analitik, 3) krijues.
	<b>Rritja e ndërgjegjësimit të politikëbërësve dhe kërkuesve shkencorë për EMI-n</b>		
<b>Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve; institucionet arsimore, OJQ/ OSHC, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, AMA etj.</b>			
Mbështetje për punë kërkimore, seminare dhe konferenca për të mbledhur së bashku palë të interesuara nga profesione dhe sektorë të ndryshëm.	Mundësimi i trajnimit online i politikëbërësve rreth edukimit për median dhe informacionin.	Krijimi i një ambienti të sigurtë ku fëmijët dhe studentët të bëjnë zgjedhjet e tyre si konsumatorë të medias, gjë që ndihmon në zhvillimin e tyre të plotë.	

## **2. Rekomandime për EMI-n në nivelin e edukimit informal dhe joformal**

Në nivelin e edukimit informal dhe joformal sugjerohet që të krijohet një sinergji mes nismave dhe aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë që janë duke kontribuar për përparimin e EMI-t në Shqipëri. Po ashtu, është e domosdoshme një qasje gjithëpërfshirëse që targeton të gjitha grupmoshat e shoqërisë (jo vetëm të rinjtë, por edhe të rriturit, prindërit, komunitetin në tërësi) pavarësisht statusit social, arsimor apo të punësimit. Krijimi i kurseve masive të aksesueshme nga të gjithë, në gjuhën shqipe është një rekomandim specifik që kontribuon në arritjen e kapaciteteve të EMI-t në shkallë të gjerë.

<b>Rritja e kapaciteteve të EMI të të gjitha grupeve shoqërore nëpërmjet edukimit informal dhe joformal.</b>			
<b>OSHC, organizatat ndërkombëtare (UNICEF, CFI, UNDP, etj); biblioteka publike dhe ato të shkollave, organizata mediatike, AMA, etj.</b>			
<b>OBJEKTIVA STRATEGJIKË</b>	Nxitja e nismave për aktivitete dhe iniciativa joformale dhe informale nga OJQ dhe sektori privat rreth edukimit të të gjitha grupmohave për median dhe informacionin.	Mbështetja për krijimin e shoqatave të mësuesve apo organizatave të ngjashme që punojnë me iniciativa EMI.	
	<b>Ndërgjegjësimi rreth edukimit për median dhe informacionin midis profesionistëve të medias dhe publikut të gjerë</b>		
	<b>OSHC, organizatat ndërkombëtare (UNICEF, CFI, UNDP, etj); biblioteka publike dhe ato të shkollave, organizata mediatike, AMA, etj.</b>		
	Adoptimi dhe eksperimentimi me udhëzime dhe teknika të reja për median e shkruar dhe elektronike për të promovuar EMI-n dhe materiale mediatike që krijohen nga përdoruesit	Përmirësimi i etikës në media dhe inkurajimi i edukimit për median dhe informacionin. Krijimi i kurseve MOOC që mund të aksesohen nga publiku i gjerë dhe që trajton veçanërisht EMI-n në tërësinë e saj.	Nxitja e iniciativave nga organet rregullatore për edukimin e publikut për median dhe informacionin, si respektimi i Kodit të Transmetimit, komunikimi me Këshillin e Ankesave të AMA rreth përmbytjes mediatike, forcimi i Këshillit të Dëgjuesve dhe Shikuesve në RTSH, etj.
	Promovimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe debatit profesional rreth udhëzimeve etike për organet e medias, si edhe shqyrtimit sistematik i vazhdueshëm profesional mbi cilësinë e raportimit në media.	TVSH duhet të luajë një rol të dorës së parë midis organeve të edukimit dhe komunikimit në lidhje me EMI-n, nëpërmjet programeve të trajnimit për studentë, si dhe nëpërmjet prodhimit të materialit mediatik që lidhet me EMI-n.	Organizimi i eventeve publike, vjetore, të ngjashme me "Javën globale të EMI-t" ku të flitet për praktikatat më të mira EMI të vitit përkatës; si edhe krijimi i sinergjisë mes nismave dhe aktorëve që veprojnë në vend.

# SHTOJCA NUMËR 1

## Lista e të intervistuarve për EMI-n

Institucione publike	Institucione Arsimore/ Kulturore	Institucione publike	Institucione publike
Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, FHF, UT	Radio Televizioni Shqiptar (RTSH)	Qendra për të Drejtat e Fëmijëve Shqipëri (CRCA)
Ministria e Kulturës	Departamenti i Shkencave të Komunikimit, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër.	Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)	TUMO Center Tirana
ASCAP	Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, FSHS, UT	Këshilli Shqiptar i Medias	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
Kryeministria/ NJPZHB	Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Aleksandër Xhuvani.	Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore	Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën (SHKEJ)
Biblioteka Kombëtare	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	Faktoje.al	Hand in Hand against Nation Apathy (HANA)
Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)	Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC)	CFI Media Development
Muzeu Historik Kombëtar	UNICEF	ABC Media Center	SchoolMe. Education

## **SHTOJCA NUMËR 2**

### **Koncepti më i gjerë i UNESCO-s për edukimin për median dhe informacionin**

“EMI, si nocion i gjerë dhe koncept i përbërë, përmban në vetvete njohuri, aftësi dhe qëndrime që i japin mundësi qytetarëve që të:

- Kuptojnë rolin dhe funksionin e medias dhe formave të tjera të përçimit të informacionit në një shoqëri demokratike;
- Kuptojnë kushtet që mundësojnë plotësimin e këtyre funksioneve;
- Të njohin dhe të shprehin nevojën për informacion;
- Të gjejnë dhe të sigurojnë akses në informacion;
- Të vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin dhe përmbajtjen e medias dhe përçuesve të tjerë të informacionit, duke përfshirë edhe vlerësimin e burimeve nga interneti për sa i përket autoritetit, besueshmërisë dhe përditësimit të informacionit;
- Të marrin dhe organizojnë informacionin dhe përmbajtjen në media;
- Të përpunojnë apo të nxjerrin përfundime nga idetë abstrakte të materialit mediatik;
- Të komunikojnë në mënyrë etike dhe të përgjegjshme njohuritë e mbledhura prej tyre kundrejt shikuesve apo lexuesve në një formë dhe medium të përshtatshëm;
- Të jenë në gjendje që të aplikojnë aftësitë në lidhje me TIK për të përpunuar informacionin dhe për të prodhuar material mediatik duke qenë në të njëjtën kohë përdorues të medias;
- Të angazhohen me median dhe përçues të tjerë të informacionit, duke përfshirë edhe ato në internet, për të shprehur vetveten, lirinë e shprehjes, dialogun ndërkulturor dhe pjesëmarrje demokratike.



## **SHTOJCA NUMËR 3**

### **Dokumentet kurrikulare që ndikojnë mbi politikat EMI**

Kurrikula bërthamë dhe korniza kurrikulare janë miratuar në vitin 2014 dhe përbëjnë bazën e përmbajtjes arsimore në sistemin para-universitar në vend. Korniza Kurrikulare është një “dokument kyç për organizimin e sistemit arsimor, që orienton aktorët arsimorë dhe palët e interesuara për aspektet kryesore të kurrikulës, si bazë për të siguruar në mënyrë efektive arsimin cilësor për të gjithë.” Në dokumentin e kornizës thuhet se një nga arsyt kryesore për ndryshimin e kurrikulave ekzistuese ka të bëjë, midis të tjerave, edhe me nevojën për të rritur nivelin e njohurive në shoqëri dhe me nevojën për të përgatitur nxënësit që të integrohen me botën dixhitale. Këto prioritete i vënë si detyrë shkollës që të përshtatet me zhvillimet dhe nevojat e reja, si mësimi i njohurive apo kompetencave të reja nga nxënësit dhe përmirësimi i njohjes së teknologjisë dixhitale nga sistemi shkollor, për të arritur alfabetizmin e plotë funksional. Sipas kornizës kurrikulare, në përfundim të studimeve para-universitare nxënësit duhet të jenë në gjendje që të:

- Ndërveprojnë dhe bashkëpunojnë me të tjerët duke përdorur shumëllojshmërinë e mediave digjitale;
- përdorin media dhe formate të ndryshme për komunikimin e informacionit dhe ideve në mënyrë efektive për audienca të shumta;
- zhvillojnë vetëdijen dhe ndërgjegjësimin mbi globalizimin dhe larminë kulturore duke u përfshirë në ndërveprim me nxënës nga kultura të tjera;
- kontribuojnë në rritjen e rendimentit të punës në grupet e projekteve për të sjellë produkte origjinale apo për të zgjidhur probleme;

- ruajnë etikën e komunikimit personal dhe në grup;
- gjejnë, organizojnë, analizojnë, vlerësojnë, përpunojnë dhe përdorin informacionin nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- përzgjedhin burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshtatshmërinë e tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrash të veçanta;
- ruajnë sigurinë e identitetit virtual dhe privatësinë personale;
- përzgjedhin dhe përdorin aplikacionet në mënyrë efektive dhe produktive;
- zgjidhin problemet e sistemeve dhe aplikacioneve;
- kuptojnë dhe përdorin saktë sistemet e teknologjisë.

Kurrikulat bërthamë janë të detyrueshme për të gjitha shkollat e sistemit para-universitar në vend, duke përfshirë edhe institucionet arsimore private. Në fushë e TIK dhe teknologjisë, kurrikula bërthamë identifikon disa nga subjektet bazë që duhet të përfshihen në procesin mësimor:

- Analizë e thelluar e të dhënave (analizë dhe interpretim të dhënash statistikore)
- Motorët e kërkimit dhe mjetet mediatike (të njohin tipare specifike të motorëve të kërkimit dhetë jenë në gjendje të kërkojnë informacione online)
- Gjuha e programimit (aplikimi i formulave bazë)
- Teknologjia, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit (përkufizimi i teknologjisë dhe sistemet teknologjike dhe analiza e ndikimit të tyre në zhvillimin e shoqërisë, përdorimi në mënyrë të avancuar të mediave për realizimin e detyrave, dhe projekteve)
- Komunikimi grafik (përdorimi i paraqitjes grafike në komunikim)

- Strukturat, mekanizmat dhe materialet teknologjike (ndërtimi dhe funksionimi i strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike)
- Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike (analiza e ndikimit të teknologjisë në ekonomi dhe biznes)
- Etika dhe kushtet e sigurta në punë (ambient i mbrojtur dhe i sigurtë) Lënda TIK planifikohet të zërë dy orë në javë në ciklin e tretë dhe së bashku me lëndën e teknologjisë përbëjnë 5.4% të planit mësimor; edhe për ciklin e katërt numri i orëve javore për TIK është dy, apo 3.2 përqind e planit mësimor. Disa nga njohuritë kryesore që duhet të marrin nxënësit përfshijnë aftësinë për të krijuar përmbajtje online në forma multimediale, shpërndarjen e informacionit dhe përmbajtjes, angazhimin në aktivitetin shoqëror në internet, bashkëpunimin dhe komunikimin nëpërmjet teknologjisë dixhitale, kërkimin dhe filtrimin e informacionit në internet, analizën kritike të informacionit, etj.

## **SHTOJCA NUMËR 4**

### **Strategjia e axhendës digjitale dhe zbatimi i saj**

Sipas Axhendës Digjitale momentalisht ka 1,496 laboratorë me kompjutera në sistemin para-universitar, dhe këta laboratorë kanë lidhje interneti broadband. Për më tepër, lënda TIK, që në vitin 2006 jepej vetëm në shkollat e mesme, u përhap në vitin 2014 edhe në nivelet e tjera më të ulëta të sistemit arsimor para-universitar. Strategjia Axhenda Digjitale ka identifikuar disa nga problemet që hasen me lëndën TIK në sistemin arsimor:

- raporti numër kompjuterash në përdorim për nxënës në shkolla është 1 me 27;
- lidhja me internetin mund të kryhet vetëm në laboratorët e kompjuterave, por jo në mjedise të tjera, si p.sh. në biblioteka;
- në më shumë se 1/3 e shkollave, nxënësit kanë mundësi të kufizuara për marrjen e informacionit online;
- është shfaqur rreziku i ekspozimit përballë përmbajtjeve të papërshtatshme;
- nuk ka ndërgjegjësim të fëmijëve për dukuri si fyerja në Internet (Cyberbullying) ose abuzimi online me fëmijët në internet.

Gjithashtu, një nga prioritetet e Strategjisë Axhenda Digjitale është edhe rritja e kapaciteteve njerëzore, kryesisht duke filluar nga përdorimi i teknologjive të reja në mënyrë sistematike dhe në moshë të re, duke filluar nga arsimi parashkollor dhe deri tek administrata publike. Duke pranuar faktin se çdo sistem TIK ekzistues, apo që do të ndërtohet, nuk mund të vihet në efikasitet pa ndihmën e burimeve njerëzore të parapërgatitura për përdorimin e tyre, strategjia sheh të nevojshme që të aplikohen programe të edukimit

në fushën TIK në të gjitha nivelet arsimore, deri tek ngritja e nivelit të njohurive për nëpunësit e administratës publike. Prioritetet e vendosura për vitet 2015-2020 nga Strategjia Axxhenda Digjitale përfshijnë përmirësimin e përgjithshëm të infrastrukturës kombëtare të TIK-ut, rritja e aksesit me shpejtësi të lartë transmetimi, (të paktën 100 Mbps deri në 50 përqind të familjeve dhe, të paktën 30 Mbps për të gjithë popullatën), rritja e përqindjes së popullsisë që përdor internetin nga 50 përqind, në fund të 2013, në 90 përqind, në fund të 2020, dhe lidhja e të gjitha shkollave me akses interneti broadband. Më konkretisht, përsa i përket TIK-ut në arsim, plani i veprimit të strategjisë thotë se disa nga hapat që janë të nevojshme të ndërmerren duhet të përfshijnë digjitalizimin e bibliotekave të institucioneve parauniversitare, trajnimin e mësuesve rreth lëndës së TIK, ngritjen e sistemit të mësimit mbi bazë elektronike (e-learning), dhe vazhdimi i punës me TIK në arsimin para-universitar.

## **SHTOJCA NUMËR 5**

### **Legjislacioni mbi median**

Ky kapitull merr shkurtimisht në shqyrtim legjislacionin mbi lirinë e medias dhe lirinë e informacionit si për mediat tradicionale kryesore ashtu edhe për ato online, si dhe kontaktin real me mediat dhe informacionin në vend.

Legjislacioni mbi lirinë e shprehjes

Liria e shprehjes është një nga liritë dhe të drejtat vetjake të njohura nga Kushtetuta e Shqipërisë me nenin 22:

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.
3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.
4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit. Ligji për shtypin thotë: "Shtypi është i lirë. Liria e shtypit mbrohet me ligj." Ashtu edhe neni 4i Ligji për mediat audiovizive dhe rendit lirinë e shprehjes dhe lirinë e operatorëve të mediave audiovizive si një nga parimet themelore në fushën e transmetimeve audiovizive :
  - (1) Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e tyre dhe parimet:
    - a) veprimtaria e transmetimeve audiovizive është e lirë;
  - (2) Operatorët e shërbimit audioviziv, gjatë veprimtarisë së tyre të gomave, udhëhiqen edhe nga këto parime:
    - a) garantimi i lirisë së shprehjes;
    - b) garantimi i së drejtës së informimit.

## **SHTOJCA NUMËR 6**

### **Media, informacioni dhe tendencat e internetit**

Tablloja mediatike shqiptare është goxha dinamike, përse i përket numrit të organeve mediatike. Momentalisht ka 15 gazeta të përditshme, duke përfshirë këtu edhe gazeta sportive, ndonëse kemi më pak se tre milionë banorë dhe shtypi nuk shpërndahet nëpër të gjithë territorin e vendit. Edhe numri i mediave audiovizive është goxha i lartë: janë lëshuar pesë licensa për platforma digjitale kombëtare, ka 45 stacione televizive lokale, si dhe radiotelevizioni publik RTSH që transmeton në 12 kanale, nëpërmjet platformës së tij digjitale, duke përfshirë edhe dy degë të televizionit në rrethe<sup>44</sup>. Përse i përket transmetimeve radiofonike, ka dy radio kombëtare, 53 radio lokale dhe katër radio komunitetesh. Përveç tyre, funksionon edhe radio Tirana, që transmeton në gjashtë kanale radio dhe katër degë nëpër rrethe.<sup>45</sup>

Tablloja e mediave online është shumë më kaotike dhe në kushtet e mungesës së statistikave zyrtare apo mënyrave të tjera për të përllogaritur numrin e mediave online, vetëm mund të spekulohet në lidhje me përmasat e këtij sektori të medias. Sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, mendohet se në vend ka më shumë se 800 media online<sup>46</sup>. Rritja dramatike e numrit të mediave online vjen si rrjedhojë e kostove relativisht të ulëta në krahasim me sektorët e tjerë të medias, dhe përhapjes së gjerë të internetit nëpër

---

<sup>44</sup> Autoriteti i Mediave Audiovizive. (2020). Lista e stacioneve televizive, <http://ama.gov.al/subjekte-audiovizive/>

<sup>45</sup> Autoriteti i Mediave Audiovizive. (2020). Lista e stacioneve radio, <http://ama.gov.al/subjekte-audio/>

<sup>46</sup> Intervistë me Aleksandër Çipën, kryetar i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, 25 maj 2020.

të gjithë vendin. Sipas entit rregullator të komunikacioneve elektronike, niveli i përhapjes së internetit në fund të vitit 2019 ishte 75 për qind<sup>47</sup>. Po kështu, shqiptarët janë përdorues të rregullt të rrjeteve sociale, veçanërisht në Facebook, me rreth 1.4 milionë faqe, apo një nivel përhapje prej 49 për qind, deri në fund të muajit janar 2020<sup>48</sup>.

Burimet financiare për këtë numër relativisht të madh të mediave të llojeve të ndryshme nuk duket se janë edhe aq të shumta apo të mjaftueshme, dhe ka mungesë të theksuar transparence mbi të ardhurat e medias, veçanërisht për mediat online. Sipas të dhënave të publikuara nga revista ekonomike Monitor, llogaritet se gjatë viteve të fundit tregu i reklamave në vend shkon nga 37–40 milionë euro në vit, me parashikime të zymta për vitin 2020, si pasojë e reduktimit të fondeve të reklamave nga kompanitë për të mbuluar humbjet<sup>49</sup>. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve thithet nga stacionet televizive, me rreth 70 për qind të tregut. Shumica e këtyre fondeve shkon për dy stacione televizive kombëtare, që mbledhin 11 milionë nga rreth 30 milionë euro që kalojnë për të gjitha stacionet televizive<sup>50</sup>. Radio duket se mban një pozicion stabil në tregun e reklamave, me rreth një milionë euro të ardhura. Fondet nga reklamat për shtypin e shkruar kanë rënë ndjeshëm dhe arrijnë në rreth 1.5 milionë euro, ndërsa mediat online i kanë rritur në mënyrë të vazhdueshme të ardhurat nga reklamat, ndonëse kohët e fundit ka patur njëfarë frenimi. Mediat online marrin 2.5 milionë euro në

---

<sup>47</sup> Statistika Botërore Interneti, <https://www.internetworldstats.com/europa2.htm#al>

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> Revista Monitor, “Tregu i reklamave në ngërc, furnizonte mediat me rreth 40 milionë euro në vit,” 28 mars 2020, <https://www.monitor.al/tregu-i-reklamave-ne-ngerc-furnizonte-mediat-me-40-milione-euro-ne-vit/>

<sup>50</sup> Po aty.



vit, sipas raportimeve më të fundit<sup>51</sup>. Të gjitha këto të dhëna janë siguruar falë një pune serioze, që është ndërmarrë kryesisht nga revista Monitor, në bashkëpunim me agjenci reklamash, duke analizuar e krahasuar të dhënat nga bilanci e organeve mediatike, ndërkohë që mungojnë statistika apo raporte financiare zyrtare mbi situatën reale të tregut të reklamave për median, apo gjendjen financiare të mediave në përgjithësi. Në këtë kontekst, si pasojë e mungesës së të dhënave të besueshme dhe transparente, pyetja se si mund të mbijetojnë një numër kaq i madh mediash në këtë treg, nuk mund të marrë akoma një përgjigje përfundimtare.

## **IMAZHI I MEDIAS TE PUBLIKU**

Në sondazhin e ndërmarrë nga ISHM, krijimi i një panorame rreth imazhit të medias tek publiku, është realizuar duke u fokusuar në terma të tillë të imazhit si niveli i përmbushjes së misionit publik nga ana e medias, niveli i lirisë, shkalla e pavarësisë nga politika dhe nga interesat e biznesit, ndikimi në luftën kundër korrupsionit, ekspozimi i vetë mediave ndaj korrupsionit etj.

Siç rezulton edhe nga analiza e rezultateve të sondazhit, publiku shqiptar në shumicën dërrmuese, vlerëson se mediat kanë një rëndësi të madhe për demokracinë e një vendi. Rreth 70% e të anketuarve i konsiderojnë mediat si shumë të rëndësishme apo maksimalisht të rëndësishme për nivelin demokratik të një shoqërie. Ndërkohë rreth një e katërta e të anketuarve janë më pak optimistë dhe shprehen se mediat janë deri diku të rëndësishme për demokracinë, kurse vetëm një pjesë e vogël e publikut shqiptar është skeptik ndaj rolit të medias në raport me demokracinë.

---

<sup>51</sup> Po aty.

Edhe pse i njeh medias një rol shumë të rëndësishëm në raport me demokracinë, publiku shqiptar është më i rezervuar kur pyetet se sa i kanë shërbyer në përgjithësi mediat e lajmeve demokracisë dhe interesit publik në Shqipëri. Rreth gjysma e të anketuarve (48.6%) shprehen se mediat i kanë shërbyer deri diku demokracisë dhe interesit publik. Kësisoj, për këtë aspekt, mbizotëron vlerësimi mesatar, përkundër vlerësimit minimal apo maksimal që zënë secili rreth një të katërtat e të anketuarve.

## **NIVELI I BESIMIT TE MEDIAT DHE TEK INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE**


Besimi është një faktor mjaft i rëndësishëm në marrëdhëniet media-publik. Niveli i besimit të publikut tek media përcaktohet nga niveli i përmbushjes së misionit publik të medias dhe nga cilësia dhe standartet e mesazhit dhe të produktit mediatik. Kur media dështon të jetë, qoftë edhe pjesërisht, përfaqësuese dhe mbrojtëse e interesit publik dhe kur cilësia dhe standartet gazetareske bien, fillon të shfaqet edhe kriza e besimit.

Në kuadrin e këtij studimit, besimi i publikut tek media është matur fillimisht brenda kuadrit të besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike për të parë se ku qëndron besimi ndaj medias në raport me besimin ndaj institucioneve të tjera. Mandej është testuar besimi sipas kategorive të ndryshme të mediave tradicionale dhe atyre online dhe sipas profilit të mediave të bazuar tek shtrirja gjeografike e tyre. Gjithashtu, studimi hulumton dhe analizon edhe besimin e publikut tek kategoritë e ndryshme të burimeve njerëzore të medias, si dhe tek kategoritë e ndryshme të lajmeve. Hulumtimi dhe studimi i media trust është përqendruar kryesisht në dimensionin informues të mediave dhe është bazuar në tre prej principeve kryesore të media trust, të përcaktuara dhe të aplikuara edhe

nga American Press Institute siç janë: plotësia, saktësia dhe balanca në informim.<sup>52</sup>

Në mesin e institucioneve publike të shoqërive demokratike, media gëzon një besim relativisht të lartë tek publiku. Edhe në Shqipëri, media është radhitur ndër institucionet publike me besueshmëri më të lartë se sa një numër institucionesh të tjera publike. Në sondazhin e ISHM, besimi tek institucionet publike u testua edhe lidhur me kriterin e shërbimit të tyre ndaj interesit publik. Termi “interes publik” këtu është përdorur në kuptimin e të mirës së përbashkët. Më poshtë po paraqesim rezultatet e dala nga përgjigja e pyetjes: “Sa besoni tek institucionet e mëposhtme ku bëhet fjala për shërbimin e tyre ndaj interesit publik?”

*Nga 1 deri në 10 (ku 1 = fare dhe 10 = maksimalisht), sa besoni tek institucionet e mëposhtme kur bëhet fjalë për shërbimin e tyre ndaj interesit publik:*



<sup>52</sup> *The meaning of trust in news*, American Press Institute, Link: <https://www.americanpressinstitute.org/publications/reports/survey-research/the-meaning-of-trust-in-neës/>

Siç shihet, media renditet e treta për nga niveli i besimit në raport me shërbimin ndaj interesit publik. Vetëm dy institucione publike, shkolla dhe institucionet fetare, kanë një shkallë besimi më të lartë se mediat. Në këtë spektër të besimit, media rezulton të ketë një nivel pak mbi mesataren, ndërkohë që për shumicën e institucioneve të tjera publike, niveli i besimit është nën mesataren, duke konfirmuar kështu ekzistencën e një krize besimi që nis me krizën e besimit ndaj qeverisjes dhe vijon me krizën e besimit të publikut tek prokuroria, parlamenti, gjykatat dhe partitë politike. Bie në sy në këtë sondazh kredibiliteti i ulët i partive politike tek publiku, të cilat verifikohen të kenë një nivel besimi edhe më të ulët se sa organet e drejtësisë. Paradoksalisht, pesë institucionet që kanë peshën më të madhe vendimmarrëse për shërbimet ndaj interesit publik, shënojnë edhe nivelin më të ulët të besimit të publikut.

Në hulumtimin e ndërmarrë, besimi i publikut tek media është testuar edhe në bazë të kategorive të mediave. Si kriter vlerësimi, në këtë rast, janë përdorur plotësia, saktësia edhe paanshmëria e informimit. Sic shihet edhe në grafikën e mëposhtme, bazuar në këto kritere, televizioni është media që gëzon besimin më të lartë të publikut krahasuar me kategoritë e tjera të mediave. Në vlerësimin nga 1 deri në 10, televizioni arrin të vlerësohet me 5.22, një koeficient ky që është mes nivelit mesatar dhe të lartë të besimit. Radioja dhe gazetat renditen në nivelin mesatar të besimit të publikut, duke konfirmuar faktin që mediat tradicionale vijojnë të mbeten mediat më të besueshme për publikun. Për sa i takon mediave vetëm online të lajmeve dhe mediave sociale, ato kanë një nivel besueshmërie nën mesataren.

## KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE<sup>53</sup>

Tregu i komunikimeve elektronike dhe postare ka shënuar zhvillime pozitive në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që u ofrohen përdoruesve duke ndjekur trendin drejt shërbimeve të bazuara në internet dhe rritjes së shërbimeve postare nga tregtia elektronike (e-commerce). Vendosja në përdorim e frekuencave të brezit 800 MHz, gjatë vitit 2019 nga dy sipërmarrësit Vodafone Albania sh. a dhe Telekom Albania sh. a është shoqëruar edhe me investime në teknologji të reja nga këta operatorë që do të vijojnë edhe përgjatë vitit 2020. Frekuencat e brezit 800 MHz ofrojnë kapacitete më të larta në rrjetet celulare dhe kjo ka bërë të mundur edhe përmirësimin e shërbimeve të këtyre operatorëve, në veçanti rritjen e shpejtësive të shërbimit internet kundrejt pajtimtarëve.

Vëllimi i të dhënave të transmetuara përmes internetit në rrjetet mobile ka shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2019, volum i cili është rritur me rreth 15 % krahasuar me vitin 2018.

Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në internet gjatë vitit 2019 konsistonte në rreth 2.4 milion përdorues që e kanë përdorur rrjetin të paktën një herë gjatë vitit 2019 dhe rreth 1.7 milion përdorues aktivë (përdorim të internetit në tre muajt e fundit).

Ligji nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, gjatë vitit 2019 ka pësuar ndryshime të pasqyruara në Ligjin nr.92/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të

---

<sup>53</sup> AKEP (2019) Raporti Vjetor 2019.

ndryshuar””, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 18.12.2019, dhe hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ndryshimet ligjore vendosin në thelb detyrimin e çdo sipërmarrësi që ofron shërbime të internetit (Internet Service Provider-ISP) për të respektuar në çdo rast kërkesën e AKEP për kufizimin e transmetimeve të përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, bazuar kjo në nenin 12 pika 3 ku parashikohet se: “AKEP-i bashkëpunon me AMA-n në përpunime me parashikimet e këtij ligji dhe dispozitave të tjera nënligjore, si dhe siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Ankesave dhe organeve të tjera të AMA-s, duke detyruar ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet të zbatojnë aktet/vendimet përkatëse të këtyre autoriteteve, sipas afateve dhe procedurave të parashikuara në legjislativonin në fuqi”. AKEP nuk mund të gjykojë, kërkojë apo të vendosë me iniciativën e tij (motu proprio), për kufizime në transmetimet me përmbajtje të paligjshme apo të dëmshme, por mund t’i drejtohet sipërmarrësit, që ofron rrjetin dhe/ose shërbimet e komunikimit elektronik, për ndërprerjen dhe bllokimin e transmetimit të kësaj përmbajtje vetëm në bazë dhe për zbatim të një akti administrativ të një organi/institucioni përgjegjës për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së përmbajtjeve të transmetimeve. Roli i AKEP në këtë proces, kufizohet vetëm për sa i përket inspektimit dhe mbikëqyrjes të veprimtarisë së sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike, nëse kanë kryer kufizimet në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme në përpunime me vendimet që kanë përcjell organet përgjegjëse.



LETËR POZICIONIMI MBI  
**POLITIKAT DHE STRATEGJITË KOMBËTARE  
PËR EDUKIMIN PËR MEDIAN DHE  
INFORMACIONIN NË SHQIPËRI**



### ***Tabela e përmbajtjes:***

- I. Nevoja për ndërhyrje në nxitjen e Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI)
- II. Situata e EMI-t në Shqipëri
- III. Parimet themelore/udhëzuese (politikat)
- IV. Pozicionimi i përgjithshëm
- V. Direktiva strategjike për EMI-n
- VI. Rekomandime Strategjike nga konsultimet kombëtare për EMI-n
- VII. Përfundime

## **I. Nevoja për ndërhyrje në nxitjen e Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI)**

Media dhe informacioni luajnë një rol vendimtar në një shoqëri demokratike pasi u japin mundësi qytetarëve që të marrin vendime të mirëinformuara, ndikojnë pozitivisht në fuqizimin e pozitës dhe nxisin dhënien e kontributit të tyre në shoqëri. Potenciali që sjellin teknologjitë e reja të informacionit është shumë i madh, kështu që qytetarët dhe media duhet të jenë në gjendje që t'i përdorin me zgjuarsi këto mjete të reja dhe të shmangin rreziqet që ato mbartin me vete. Në këtë drejtim, njohja dhe edukimi për median dhe informimin (EMI) ka një rëndësi të dorës së parë në zhvillimin e mendimit kritik dhe përdorimit efikas të teknologjisë së medias dhe komunikacionit në një epokë kur përballemi me një mori informacionesh.

Tabloja mediatike shqiptare është dinamike përse i përket numrit të organeve mediatike. Momentalisht ka 15 gazeta të përditshme, duke përfshirë këtu edhe gazeta sportive, ndonëse kemi më pak se tre milionë banorë dhe shtypi nuk shpërndahehet nëpër të gjithë territorin e vendit. Edhe numri i mediave audiovizive është mjaft i lartë: janë lëshuar pesë licensa për platforma digjitale kombëtare, ka 45 stacione televizive lokale, si dhe radiotelevizioni publik RTSH që transmeton në 12 kanale, nëpërmjet platformës së tij digjitale, duke përfshirë edhe dy degë të televizionit në rrethe. Përse

i përket transmetimeve radiofonike, ka dy radio kombëtare, 53 radio lokale dhe katër radio komunitetesh. Përveç tyre, funksionon edhe Radio Tirana, që transmeton në gjashtë kanale radio dhe katër degë nëpër rrethe.

Nga ana tjetër, tabloja e mediave online është shumë më kaotike dhe në kushtet e mungesës së statistikave zyrtare apo mënyrave të tjera për të përlllogaritur numrin e mediave online, vetëm mund të spekulohet në lidhje me përmasat e këtij sektori të medias. Sipas të dhënave të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë, mendohet se në vend ka më shumë se 800 media online. Rritja dramatike e numrit të mediave online vjen si rrjedhojë e kostove relativisht të ulëta në krahasim me sektorët e tjerë të medias dhe përhapjes së gjerë të internetit nëpër të gjithë vendin. Sipas entit rregullator të komunikacioneve elektronike, niveli i përhapjes së internetit në fund të vitit 2019 ishte 75%. Po kështu, shqiptarët janë përdorues të rregullt të rrjeteve sociale, veçanërisht në Facebook, me rreth 1.4 milionë faqe, apo një nivel përhapje prej 49 për qind, deri në fund të muajit janar 2020.

Me zhvendosjen me shpejtësi të qendrës së gravitetit të medias shqiptare online, relievi mediatik duket se është përmbysur. Gazetaria shqiptare përjeton fenomenin e portalizimit dhe facebook-izimit dhe ashtu si në vende të tjera prodhon vetë dhe përballet me lajmë të rreme të përditshme. Teoritë e konspiracionit, që më parë gjendeshin vetëm në mediat ekstremiste, tani po dominojnë gjerësisht median tradicionale. Disinformimi paraqitet si një problem serioz që duhet përballuar. Kjo u vu re qartë gjatë pandemisë së COVID-19, kur teoritë e konspiracionit dhe dezinformacionet u përhapën me shpejtësi.

*Përvoja ka treguar se publiku shqiptar nuk ka imunitetin e nevojshëm dhe aftësitë e duhura për t'u përballur me lajmet e rreme (fake news) dhe dezinformacionet, nuk ka qasjen*

*kritike të domosdoshme për të dalluar të vërtetën, për të dalluar çfarë është fake news dhe çfarë është real news* etj. Indexi i Media Literacy i 2018 e vendos Shqipërinë gati në fund të listës së vendeve europiane, duke lënë pas vetëm Turqinë dhe Maqedoninë e Veriut. Renditje kjo që sinjalizon domosdoshmërinë e ndërhyrjeve të menjëhershme dhe planifikimin e ndërhyrjeve strategjike për të përmirësuar nivelin e edukimit për median dhe informimin në Shqipëri.

Ndryshimet thelbësore në panoramën mediatike dhe informative tregojnë se shkollat nuk janë më të vetmet burime të njohurive dhe nxënies. Kjo nënkupton edhe rolin që duhet të luajnë institucionet mësimdhënëse informale dhe të ndërmjetme, si bibliotekat, arkivat, muzetë dhe institucione të tjera kulturore.

Në Shqipëri përgatitjet dhe përpjekjet për edukimin për median dhe informacionin janë ende në hapat e para dhe projekti në fjalë është një ndër ndërhyrjet më të konsoliduara pasi synon ta bëjë EMI-n pjesë të kurrikulës zyrtare në arsimin parauniversitar.

## **II. Situata e EMI-t në Shqipëri**

Në vendin tonë ***nuk ekziston ende një strategji që orienton politikat kombëtare për edukimin mediatik dhe informacionin, për t'ju përgjigjur nevojave në këtë fushë.*** Strategji të ndryshme kombëtare (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim; Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Para-Universitar, Agjenda Digjitale, Strategjia Kombëtare për Kulturën, etj.) cekin një apo disa elementë të EMI-t, sikurse është për shembull digjitalizimi i shërbimeve dhe rritja e aftësive kompjuterike, ***por mungon qasja e plotë e zhvillimit të kompetencave në EMI*** (të menduarit kritik,

vlerësimi i informacioneve dhe burimeve të informacionit, aftësia për të aksesuar dhe lokalizuar burimet informative, krijimi i përmbajtjeve, nxitja e qytetarisë aktive, të kuptuarit e medias dhe sistemeve të informimit, etj).

***Kjo mungesë pasqyrohet gjithashtu edhe në të treja nivelet e edukimit, atij formal, joformal dhe informal.*** Ndonëse në sistemin parauniversitar i është dhënë përparësi përdorimit të TIK gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, ***kjo përparësi është e kufizuar vetëm në aspektin dhe edukimin teknologjik dhe përdorimit të pajisjeve,*** duke mos u përqendruar në kompetencat e tjera të EMI-t. Integrimi i kurrikulës për EMI-n në kurrikulën e arsimit parauniversitar, do të shtonte njohuritë dhe aftësitë e nxnësve dhe mësuesve në fushën e edukimit për median dhe informacionin.

***Në nivel universitar, koncepte të caktuara të EMI-t mësohen nga programe të ndryshme të formimit akademik të ciklit Bachelor dhe Master,*** në fakultete të universiteteve publike (Universiteti i Tiranës, Aleksandër Moisiu, Aleksandër Xhuvani, etj.) dhe private (Universiteti Beder, etj.). Këto koncepte në varësi të degëve përfshijnë njohjen me median, audiencën, kompetencën digjitale, prodhimin e përmbajtjeve multimediale, etj., por ajo që ***mbetet për t'u theksuar është mungesa e formimit të përgjithshëm për EMI-n. Është e domosdoshme që ndërhyrjet EMI në nivel universitar të planifikohen në tre nivele: 1) operacional (ku të përfshihet promovimi, ndërgjegjësimi 2) analitik (të menduarit kritik, aftësitë analizuese, verifikimi i burimeve, reagimi ndaj fake news dhe propagandës etj.) dhe 3) krijues (zhvillimi i aftësive për të krijuar përmbajtje, si edhe për ta publikuar atë).***

Nevoja për edukimin për median dhe informimin është njohur dhe ka filluar të tërheqë vëmendjen e aktorëve

të ndryshëm. Fakti që ka nisma, ndonëse sporadike dhe afatshkurtra, është një tregues pozitiv në këtë drejtim. Megjithëse nismat janë prezente, mungesa e organizatave dhe shoqatave të forta në nivel komunitetesh në fushën e arsimit, medias, dhe informacionit, ka penguar zhvillimin e mëtejshëm të arsimit joformal në fushën e EMI-t.

Nga kërkimi që është bërë, vihet re që nismat dhe kontributi i dhënë për EMI-n në edukimin formal është i përqendruar kryesisht tek TIK dhe kompetencat digjitale; në edukimin joformal është afatshkurtër, sporadik dhe i pakoordinuar mes aktorëve kryesorë. Këto nisma janë të përqendruara kryesisht tek gazetaria, krijimtaria multimediale, aftësimi digjital tek fëmijët dhe të rinjtë, mirëpo ende nuk ka një kontribut të mirëfilltë për EMI-n sikurse përkufizohet nga UNESCO. Ndërsa në edukimin informal, EMI është përqendruar tek aksesimi në informacion, ofrimi i shërbimeve digjitale, si edhe nxitja e leximit dhe rritja e numrit të frekuentuesve në institucionet përkatëse duke kontribuar kështu në disa elementë të përfaqësimit holistik të EMI-t, por jo në tërësinë e tij.

Nisur nga nevojat e identifikuar dhe nga boshllëqet në nismat ekzistuese, në kuadër të këtij projekti është hartuar draft-kurrikula e EMI-t për mësuesit e ciklit parauniversitar në bashkëpunim me Agjencinë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP). Kurrikula është mbështetur në kuadrin e kompetencave të UNESCO-s dhe do të bëhet pjesë e kurrikulës zyrtare në ciklin e arsimit parauniversitar, që do të pilotohet fillimisht në 20 shkolla, filllore dhe të mesme, në Tiranë, Durrës, Lezhë dhe Elbasan, si në zonat rurale dhe ato urbane. Kjo do të jetë kurrikula e parë e integruar për EMI-n në arsimin formal në Shqipëri.

### **III. Parimet themelore/udhëzuese (për politikat)**

Parimet udhëzuese në këtë dokument u përmbahen vlerave demokratike që përfshijnë të drejtën e informimit dhe të drejtën e shprehjes, si dhe kontributin që japin këto vlera në përfshirjen më të gjerë të qytetarëve në proceset demokratike dhe komunikimin demokratik.

Bazuar në përkufizimin e UNESCO-s mbi edukimin për median dhe informimin, ky studim kërkon të harmonizojë përqasjen gjithëpërfshirëse ndaj EMI-t dhe ta aplikojë këtë koncept në situatën shqiptare. Synimi është të inkurajohet një përqasje që fuqizon qytetarët, nxit mendimin kritik, promovon diversitetin kulturor, gjithëpërfshirjen sociale dhe barazinë gjinore.

Ky dokument bazohet në përfshirjen e shumë palëve në këtë proces, duke ndjekur konceptin e UNESCO-s mbi edukimin për median dhe informacionin. Qëllimi i këtij dokumenti është të shërbejë si një pikënisje nxitëse për hartimin dhe zbatimin e politikave mbi EMI-n, duke u mbështetur tek politikat ekzistuese dhe aktorët kryesorë në Shqipëri.

### **IV. Pozicionimi i përgjithshëm**

Mbështetur tek rezultatet e studimit mbi situatën aktuale të Edukimit për Median dhe Informimin në Shqipëri, në trija nivelet edukative (formal, joformal dhe informal) ky raport këshillon një përqasje dhe politika më gjithëpërfshirëse në lidhje me EMI-n, që ju përgjigjen nevojave të të gjithë anëtarëve të shoqërisë, pa dallim.

Konsultimet Kombëtare dhe intervistat me aktorët kryesorë që kontribuojnë për përparimin e çështjeve të Edukimit për Median dhe Informimin në vend, nxorrën në pah ***domosdoshmërinë për ndërhyrje në rregullimin e analfabetizmit mediatik dhe informativ***. Ndonëse gjatë katër viteve të fundit përpjekjet dhe nismat për EMI- janë shtuar, ato mbeten sporadike, të pa-harmonizuara dhe të pa-koordinuara. Nevoja për të pasur singjeri mes aktorëve dhe nismave që ndërmerren mbetet në fillim të listës.

Një pikë e mirë fillimi për krijimin e sinergjive është ***përqasja shumëpalëshe, e cila është ndjekur edhe në këtë studim, për të mbledhur sugjerimet e palëve të interesuara mbi strategjinë kombëtare për edukimin për median dhe informacionin***. Një strategji e tillë nuk ka ekzistuar deri më sot, prandaj edhe kontributi i aktorëve kryesorë është me shumë vlerë në formëzimin e saj.

Aktorë të rëndësishëm në avancimin e edukimit për median dhe informacionin mbeten qeveria qendrore-Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e cila ka shfaqur interesin dhe gadishmërinë për integrim të kurrikulës MIL në kurrikulën formale të arsimit para-universitar. Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar është palë kyçe në këtë projekt dhe ka kontribuar në hartimin e draft-kurrikulës për mësuesit, që do të jetë edhe dokumenti bazë që do të orientojë mësuesit për të përcjellë njohuritë dhe mësuar kompetencat EMI tek nxënësit.

Përveç institucioneve qendrore, palë të rëndësishme janë edhe aktorë nga fusha e arsimit universitar, biznesit, bibliotekat private dhe publike, muzetë, operatorë në fushën e informacionit, përfaqësues nga sektori privat dhe shoqëria civile. Duke u nisur nga fakti se ky është një koncept shumë i ri, që nuk është marrë në konsideratë aq sa duhet nga politikat aktuale, është krijuar mundësia që të hartohet një strategji e



qartë dhe e plotë mbi EMI-n, që do të marrë parasysh të gjitha aspektet, konceptet, objektivat, mekanizmat dhe aktorët, si edhe të sigurojë përfshirjen e tyre të plotë në proces.

Sugjerimet kryesore nga konsultimet kombëtare theksojnë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse që adreson nevojat për edukim për media dhe informacionin në të treja nivelet edukative, formal, joformal dhe informal, që njëkohësisht prek të gjitha grupmoshat (fëmijët, të rinjtë, studentët, të rriturit) dhe nxit edukimin mediatik dhe informative në shkallë të gjerë.

## **V. Direktiva strategjike për EMI-n**

Të hartohet dhe miratohet Strategjia Kombëtare për Edukimin për Median dhe Infomacionin që do të shërbejë si udhëzues për programet dhe politikat specifike që do të hartohen për të nxitur edukimin për media dhe informacionin në arsimin formal, edukimin joformal dhe informal.

EMI të adresohet sipas këndvështrimit të UNESCO-s dhe të përfshijë të gjitha fushat, si edukimin mediatik, edukimin mbi informacionin, edukimin digjital, të menduarit kritik, krijimtarinë mediatike, etj., në mënyrë që ky koncept të mund të përfshihet në dokumente strategjike, si dhe në rregulloret apo udhëzimet që do të pasojnë.

Të nxitet integrimi i EMI-t në kurrikulat zyrtare të arsimit parauniversitar në ciklin fillor, 9-vjeçar dhe të mesëm.

Të nxitet integrimi i EMI-t në kurrikulat zyrtare të arsimit universitar, specifikisht në tri drejtime: 1) operacional (ku të përfshihet promovimi, ndërgjegjësimi 2) analitik (të menduarit kritik, aftësitë analizuese, verifikimi i burimeve, reagimi ndaj fake neës dhe propagandes etj.) dhe

3) krijues (zhvillimi i aftësive për të krijuar përmbajtje, si edhe për ta publikuar atë).

Të organizohen fushata dhe aktivitete ndërgjegjësuese dhe promovuese për të njohur publikun e gjerë së pari me konceptin EMI, pasi nuk njihet si koncept.

## **VI. Rekomandime Strategjike nga konsultimet kombëtare për EMI-n**

- T'i jepet përparësi Edukimit për Median dhe Infomacionin në edukimin formal, joformal dhe informal në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria dhe krijimi i kulturës për median dhe informimin.
- Programet për edukimin për median dhe informacionin në nivel universitar të ofrojnë arsimim specifik dhe trajnim të vazhduar për të përmirësuar njohjen me median dhe informacionin tek studentët dhe profesionistët e rinj.
- Programet për edukimin për median dhe informacionin në nivel para-universitar të ofrojnë arsimim specifik dhe trajnim të vazhduar për të përmirësuar njohjen me median dhe informacionin tek mësuesit dhe nxënësit.
- Programet EMI të hartohen në mënyrë të tillë që të mundësojnë përfshirjen sa më të gjerë të qytetarëve në këtë process (pa dallim moshe, niveli arsimit, gjinie, statusi punësi) duke përmirësuar marrëdhëniet e tyre me median dhe informacionin, si dhe duke ndihmuar kristalizimin e mendimit kritik në lidhje me to.

- Programet EMI të nxisin përmirësim të profesionalizmit në media dhe krijimin e organizmave vetë-rregulluese që do të ndihmojnë në procesin e edukimit të qytetarëve për median dhe informacionin.
- Programet EMI të promovojnë vlerat e medias, arkivave, bibliotekave, muzeve dhe përçuesve të tjerë të informacionit për të përmirësuar gjithëpërfshirjen sociale, politikat anti-diskriminuese, dhe mungesën e zhvillimit në zona më mundësi të pakta ekonomike.

## VII. Përfundime

Nevoja për të sfiduar dhe adresuar analfabetizimin mediatik dhe informativ është e një rëndësie thelbësore. Konsultimet kombëtare theksojnë domosdoshmërinë për ndërhyrje në nivel kombëtar në këtë drejtim.

Ndërhyrjet sugjerohen të bëhen në arsimin formal (cikli universitar dhe para-universitar; në arsimin joformal dhe atë informal, kjo me synimin për të pasur një arritje të gjerë të të gjitha grupeve në shoqëri, për të rritur nivelin e përgjithshëm edukativ mbi EMI-n.

Krijimi i sinergjive mes palëve të interesuara në këtë proces, për të siguruar bashkërendimin e përpjekjeve të përbashkëta në fushën e edukimit për median dhe informacionin, mbetet një boshllëk që duhet mbushur.

